



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në  
“Fizioterapi”  
ofruar nga  
Institucioni i Arsimit të Lartë Koleji Universitar “REALD”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1-Prof. As. Irena Saço Kola

2-Prof. Asoc. Enkelelda Sinaj

Janar/ 2024

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të**  
**Lartë Kolegji Universitar “REALD”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “REALD”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Fizioterapi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhëri MASR nr.257 datë 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit: (2022- 2023)	14 PAE/ 7 PAK
18	Numri i studentëve:	<b>2021- 2022:</b> 21 studentë (10 italian dhe 11 shqiptar) <b>2022- 2023:</b> 22 studentë (5 italian dhe 17 shqiptar)
19	Komente / të tjera:	

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i Studimit Bachelor në "Fizioterapi", në Kolegjin Universitar "Reald" është hapur si program i ciklit të parë me Urdhër nr. 336, date 13.08.2012, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Ky program organizohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, dhe u ofrohet studentëve që zotërojnë diplomën e shkolles së mesme.

Me Urdhërin nr. 464, datë 27.07.2018, të MASR është bërë riorganizimi i programit në masën 20%, me 180 kredite në gjuhën shqipe dhe italiane me kohëzgjatje 3-vite akademike, i përbashkët me Universitetin e Fogias në Itali, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes këtyre institucioneve. Duke qenë se kontrata e bashkëpunimit nuk u rinovua për 2-vite, KUR nuk regjistroi asnjë student në vitin e parë në këtë program studimi. Në këto kushte, me qëllim vazhdimësinë dhe zhvillimin e programit bachelor në "Fizioterapi", KUR bëri riorganizimin e programit në masën mbi 20% Urdhëri MASR nr.257 datë 19.07.2021 duke e ndryshuar atë nga program i përbashkët në gjuhën shqipe dhe italiane në program në gjuhën shqipe me kohëzgjatje 3-vite akademike dhe 180 kredite, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.

Ky program studimit është hartuar për të siguruar formim të profilizuar, në gjendje që i diplomuari të veprojë me aftësi dhe pavarësi profesionale në fushën e rehabilitimit si dhe të siguroj profesionistë të rinj që t'i shërbejnë pjesës jugore të vendit, në mënyrë që të mbështesin zhvillimin e shoqërisë shqiptare dhe përparimin e arsimit dhe kërkimit universitar në nivel kombëtar.

Në mbështetje të programit të studimit, KUR ka ngritur klasat e procesit mësimor dhe laboratorët për zhvillimin e lëndëve bazë, posaçërisht Kabinetin e Fizoterapisë i pajisur me aparaturat dhe instrumentat e nevojshme. Gjithashtu, IAL mbështet programin e studimit nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve me institucione dhe qendra spitalore për kryerjen e praktikave mësimore për studentët, më konkretisht me: Spitalin Rajonal Vlorë, Spitalin Psikiatrik Vlorë, Spitalin Rajonal Fier, Poliklinika Vlorë etj.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bachelor në Kolegjin Universitar "Reald" u përpilua nga dy profesorë me përvojë dhe ekspertë të fushës: As.Prof Irena Kola dhe As.Prof Enkelelda Sinaj. Gjatë gjithë procedurës, grupi i eksperteve të jashtëm u asistua nga përfaqësi i ASCAL Znj. Aviola Bardhi.

Ekspertët e vlerësimit bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga KUR dhe ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në VKM Nr.41 datë 24.01.2018 të ndryshuar, në Udhëzimin Nr. 1 datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", VKM Nr.531, kanë kryer vlerësimin e programit të studimit Bachelor në "Fizioterapi".

Grupi i vlerësimit u njoh dhe konsultoi fillimisht dokumentat e dorëzuara nga KUR për akreditimin dhe zhvilloi vizitën në ambientet e tij ne datat 12 dhe 13 Qershor 2023 dhe u takua me përfaqësues për të kuptuar dhe pyetur më tej anëtarët kryesorë të stafit në lidhje me Vlerësimin e Brendshëm të paraqitur nga Institucioni dhe gjithë dokumentacionin mbështetës.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është konsultuar me njëri-tjetrin për të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e paraqitura në këtë raport dhe kanë rënë dakord së bashku për vlerësimin e vërtetë e të sinqert të standardeve dhe gjykon se programi i studimit Bachelor në "Fizioterapi", përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. IAL duhet të rekrutoj staf të ri akademik, me grada dhe tituj, të specializuar në fushën e këtij programi studimi, për mbulimin e ngarkesës mësimore sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Më datë 09.01.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 31/1 Prot., datë 09.01.2024, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Kolegji Universitar "REALD" kthehu përgjigje në sistemin AMS më datë 11.01.2024 dhe me shkresë Nr. 15 Prot, datë 11.01.2024.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Fizioterapi” është licencuar me Urdhër nr. 257, datë 19.07.2021, të MASR. Ai nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe është konform statutit të KUR, në përputhje me bazën ligjore të miratuar nga institucionet e Republikës së Shqipërisë, që rregullojnë veprimtarinë në fushën e arsimit të lartë. Programi nxit formimin akademik dhe shkencor bashkëkohor të studentëve, mbështetur në prioritetet strategjike të zhvillimit të KUR, që lidhen me përgatitjen e fizioterapistëve të ardhshëm me njohuri të përgjithshme dhe të profilit. <i>Evidenca nr. 2 Statuti,</i> <i>Evidenca nr. 3. Strategjia e Zhvillimit Institucional 2021 - 2026.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Referuar Statutit dhe Rregullores së Përgjithëshme të IAL, GVJ gjykon se programi i studimit është hartuar në përputhje të plotë me qëllimin, me fushën e veprimtarisë si dhe misionin e tij, të cilat synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare në përgatitjen e fizioterapistëve të ardhshëm. Përmbajtja e tij synon të japi njohuri bazë dhe të thelluara, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe specifike në fushën e fizioterapise. <i>Evidenca nr. 2 Statuti,</i> <i>Evidenca nr. 3. Strategjia e Zhvillimit Institucional 2021 - 2026</i> <i>Evidenca nr. 4. Rregullore e Përgjithshme</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Nga analiza e misionit të institucionit, shprehur edhe në rregulloren e përgjithëshme, marrëveshjet dhe objektiva të dokumentuara del qartë, që programi bachelor në “Fizioterapi” është përgatitur në përputhje me Statutin dhe me Rregulloren e Përgjithëshme të KUR. GVJ gjykon se nëpërmjet progrmit të studimit IAL është përpjekur në formimin e specialistëve të lartë dhe në përgatitjen e shkencëtarëve të rinj në përputhje me përparësitë e zhvillimit në jug të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve në vend. Në përputhje me misionin, KUR ka si objektiv në programin e studimit, të mbështesë studentët në mënyrë që ata të zhvillojnë më së miri potencialin e tyre, të nxisë krijimin, transferimin, dhe përparimin e dijes në fushën e fizioterapisë. <i>Evidenca nr. 2 Statuti,</i> <i>Evidenca nr. 3. Strategjia e Zhvillimit Institucional 2021 - 2026</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvorjen, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Duke analizuar aktivitetin akademik të deritanishmë mund të themi se, KUR ka një përvorje rreth 10-vjecare dhe kapacitetet e duhura, por jo burimet e mjaftueshme në fushën akademike për ofrimin e programit të studimit Bachelor në “Fizioterapi. <i>Stafi akademik nuk ka trajnimet dhe ekperiencen e duhur në fushën e fizioterapise. Nga analiza e CV-ve të stafit akademik vihet re mungese e theksuar e stafit profesionist me</i>

	<p><i>ekspeincen e nevojshme në këtë fushë.</i> Shumica e stafit me kohe të plotë janë me titullin Msc dhe nje pedagogë mbulon disa lëndë në planin mësimor.</p> <p>Njsia kryesore bazë ka 1 laboratore te Anatomise Humane, I laboratore te Fizioterapise, I laborator te Farmacise dhe I laborator te Kimise. Për të përmirësuar cilësinë e praktikave mësimore IAL ka lidhur marrëveshjeve me institucione dhe qendra spitalore për kryerjen e tyre, më konkretisht me: Spitalin Rajonal Vlore, Spitalin Psikiatrik Vlore, Spitalin Rajonal Fier, Poliklinika Vlore etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 24. Lista e subjekteve me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave profesionale.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 54. Lista e stafit akademik Bachelor ne Fizioterapi - viti akademik 2021-2022.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 59. CV-te e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit 2022-2023.</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha të përgjithshme dhe fusha specifike janë në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Mjekesore dhe secila prej tyre është e kodifikuar konform direktivave.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” ofron dije dhe aftësi të profilizuara, gjithashtu është i ndërthurur edhe me dije multidisiplinare.</p> <p><i>Evidenca nr. 2 Statuti,</i></p> <p><i>Evidenca nr. 4. Rregullore e Pergjithshme</i></p> <p><i>Evidenca nr. 47. Programi Mësimor Bsc në Fizioterapi, i riorganizuar (2021 - 2024)</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht, referuar analizës të dokumentacionit shqyrtues si dhe vizitës në aktivitet. KUR ka një përvojë të gjatë dhe kapacitetet e duhura, por jo burimet e mjaftueshme në fushën akademike për ofrimin e programit të studimit Bachelor në “Fizioterapi. Programi i Studimit është në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimin e IAL, nuk bie ndesh me interesat kombëtare, është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të IAL.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		X	

**Standardi I.2**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit</p>	<p>Institucioni paraqet një bashkëpunim të brendshëm për programin e studimit të njësisë kryesore - Fakultetit të Shkencave Mjekesore dhe departamenteve të tjerë. IAL i siguron këto marrëdhënie bashkëpunimi brenda tij nëpërmjet ndarjes të detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Njësitë dhe</p>

nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	personeli i angazhuar në mirëfunksionimin e programit të studimit në Fizioterapi, kanë të përcaktuara detyrat dhe rolet në përputhje me objektivat dhe qëllimet e programit. <i>Evidenca nr. 4. Rregullore e Përgjithshme</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Për zhvillim e mësimdhënies dhe të kërkimit KUR liston në evidencat shqyrtuese marrëveshje bashkëpunimi me IAL-le të tjerë kombëtar dhe të huaja. Përmendim bashkëpunimin 5-vjeçar me Universitetin e Salentos në Itali si dhe atë të Universitetit "Ismail Qemali" në Vlorë. <i>Na analiza e dokumentacionit shqyrtues GVJ vuri re se, marrëveshja me Universitetin "Ismail Qemali" ka përfunduar afatin më 25.05.2023 dhe me Universitetin e Fogias kontrata e binjakëzimit për diplomat e lëshuara nuk u rinovua.</i> <i>Evidenca nr. 28. Marrëveshja me Universitetin e Salernos, Itali</i> <i>Evidenca nr. 29. Marrëveshja me Universitetin I. Qemali, Vlorë</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Në dokumentacionin shqyrtues GVJ analizoi një list marrëveshjesh të ndryshme bashkëpunimi, nëpërmjet të cilave sigurohet përfitim tek studentët për realizimin e praktikave mësimore. Megjithatë institucioni nuk ka paraqitur një plan specifik tregues për zhvillimin dhe shpërndarjen e praktikave nëpër institucione bashëpunuese, Më konkretisht IAL ka lidhur marrëveshjeve me Spitalin Rajonal Vlorë, Spitalin Psikiatrik Vlorë, Spitalin Rajonal Fier, Poliklinika Vlorë etj. <i>Evidenca nr. 24. Lista e subjekteve me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave profesionale</i> <i>Evidenca nr. 25. Marrëveshja e bashkëpunimit me Spitalin Rajonal të Vlores.</i> <i>Evidenca nr. 26. Marrëveshja e bashkëpunimit me Spitalin Psikiatrik të Vlores</i> <i>Evidenca nr. 27. Marrëveshja e bashkëpunimit me Spitalin Rajonal të Fierit.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Njësia përgjegjëse- Departamenti i SHTM në mënyrë periodike cdo fundviti harton raportin vjetor dhe analizon rritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. Pjesë e raportit është programi i praktikës profesionale. <i>Evidenca nr. 76. Analize e Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore për kryerjen e praktikave mësimore profesionale</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht, referuar analizës të dokumentacionit shqyrtues si dhe takimeve me stafin gjatë vizitës. KUR liston historik të marrëveshjeve bashkëpunimi me shumë institucione brenda dhe jashtë vendit tonë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>																
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</b>																
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>															
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” është e organizuar me lëndë të vlerësuara në kredite përkatëse, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Referuar planit mësimor disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese, që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në lëndë dhe module të specifikuar në 5 kategori nga A-E në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018. Veprimtaritë formuese në planin mësimorë janë ndarë sipas tabelës në vijim:</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 5%;">A</th> <th style="width: 75%;">LËNDË BAZE</th> <th style="width: 20%;">18.4% (kredite)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>B</td> <td>LËNDË KARAKTERIZUESE</td> <td>52.2 % (kredite)</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE</td> <td>12.3 % (kredite)</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>LËNDË PLOTËSUESE</td> <td>13.8 % (kredite)</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>DETYRIME PËRMBYLLËSE</td> <td>3.3 % (kredite)</td> </tr> </tbody> </table> <p>Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B është më e madhe se 70%. Programi ka një kohëzgjatje prej 3- vitesh akademike me 180 ECTS. 1 kreditë ka 25 orë dhe në total programi zhvillohet në 4500 orë ( 2160 në auditor dhe 2340 orë jashtë auditorit). Plami mësimor ka gjithsej 54 lëndë të ndara në 3 vite akademike dhe secili vit ka 60 kredite.</p> <p><i>Evidenca nr. 47. Programi Mësimor Bsc në Fizioterapi, i riorganizuar (2021 - 2024).</i></p>	A	LËNDË BAZE	18.4% (kredite)	B	LËNDË KARAKTERIZUESE	52.2 % (kredite)	C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE	12.3 % (kredite)	D	LËNDË PLOTËSUESE	13.8 % (kredite)	E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3.3 % (kredite)
A	LËNDË BAZE	18.4% (kredite)														
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	52.2 % (kredite)														
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE	12.3 % (kredite)														
D	LËNDË PLOTËSUESE	13.8 % (kredite)														
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3.3 % (kredite)														
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” përmban lëndë dhe module të cilat synojnë formimin e studentit si profesionist me njohuri bazë dhe specifike bazuar në metoda e parime shkencore si dhe në metodologjinë moderne të rehabilitimit duke ndërthurur formimin teorik e praktikë. Programi synon të pajisë studentët me njohuri dhe shprehje të veçanta, që do t’u shërbejnë atyre në punësim.</p> <p>Vec lëndëve bazë dhe karakterizuese në program janë parashikuar module të etikës, menaxhimit shëndetësor gjuhë të huaja dhe psikologji.</p> <p><i>Evidenca nr. 47. Programi Mësimor Bsc në Fizioterapi, i riorganizuar (2021 - 2024).</i></p>															






<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuar veprimtaritë formuese, duke grupuar modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën respektive në kredite. Në planin e studimit të programit përqindja totale e lëndëve përkategoritë A dhe B është 70.6% dhe respekton limitin &gt;70%, e specifikuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 në rastin Bachelor.</p> <table border="1" data-bbox="622 403 1420 672"> <tr> <td>A</td> <td>LËNDË BAZE</td> <td>15-20 % (kredite)</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>LËNDË KARAKTERIZUESE</td> <td>50-55% (kredite)</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE</td> <td>12-15 % (kredite)</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>LËNDË PLOTËSUESE</td> <td>10-15 % (kredite)</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>DETYRIME PËRMBYLLËSE</td> <td>3-5 % (kredite)</td> </tr> </table> <p><i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në "Fizioterapi", i riorganizuar (2021-2024)</i></p>	A	LËNDË BAZE	15-20 % (kredite)	B	LËNDË KARAKTERIZUESE	50-55% (kredite)	C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE	12-15 % (kredite)	D	LËNDË PLOTËSUESE	10-15 % (kredite)	E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3-5 % (kredite)
A	LËNDË BAZE	15-20 % (kredite)														
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	50-55% (kredite)														
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE	12-15 % (kredite)														
D	LËNDË PLOTËSUESE	10-15 % (kredite)														
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3-5 % (kredite)														
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit në planin mësimor ka të përcaktuar ngarkesën me 19 kredita të praktikave. IAL në dokumentacionin shqyrtues liston vendet e zhvillimit të praktikës dhe bashkëpunimet me institucione spitalore dhe klinika. GVJ në evidencat shqyrtuese nuk ka gjetur një plan specifik tregues për zhvillimin dhe shpërndarjen e praktikave neper institucione e specializuara. Gjithashtu në këtë program studimi është përcaktuar forma e detyrimeve përmbyllëse, e cila është me provim mbrojtje temë diplome dhe ka 6 kredite.</p> <p><i>Evidenca nr. 24. Lista e subjekteve me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave profesionale</i></p> <p><i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në "Fizioterapi", i riorganizuar (2021-2024).</i></p>															
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Kolegjin Universitar "Reald" nuk është institucion me status të vecant.</p>															
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit ka një ngjashmëri në përmbajtje deri në 70 % me programet e studimit të ngjashme "Bachelor në Fizioterapi" të ofruara nga Fakulteti i Shkencave Mjekesore në Universitetin e Tiranës. Lëndet, emertimi i tyre është konform degeve të mjekesise. Shpërndarja e tyre shpreh një synim të programit që në fillim të viti të parë ku lëndet japin njohuritë e përgjithshme bazë për të vazhduar më tej në specialitet, eka në vitin e dytë e të tretë shton peshën e lëndëve profesionale, orët në laborator, e orët e praktikës.</p> <p><i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në "Fizioterapi", i riorganizuar (2021-2024)</i></p>															

<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>GVJ konstatoi se çdo lëndë, modul që zhvillohet në programin e studimit “Bachelor në Fizioterapi” është i pajisur me një kod unik, i cili korrespondon midis planit mësimor dhe syllabuseve.</p> <p><i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në “Fizioterapi”, i riorganizuar (2021-2024)</i></p>		
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Referuar dokumentacioni shqyrtues si dhe vizitës në aktivitet u konstatua se, KUR nuk aplikohen programe studimi të përbashkëta me institucione të arsimit të lartë, vendas apo të huaj. Marrveshja me Universitetin e Fogias në Itali nuk është rinovuar.</p> <p><i>Evidenca nr. 23. Urdhër i MASR nr. 257, datë 19.07.2021, Për riorganizimin nga program i përbashkët Bachelor në Fizioterapi, në program të ciklit të parë Bc. ne Fizioterapi.</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht, referuar analizës të dokumentacionit shqyrtues si dhe takimeve me stafin gjate vizitës në ambientet e KUR. Programi është i organizuar me lëndë të vlerësuara në kredite përkatëse, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Cdo modul që zhvillohet në programin e studimit është i pajisur me një kod unik, i cili korrespondon midis planit mësimor dhe syllabuseve.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

<p><b>Standardi II.2</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njesia kryesore dhe ato bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi” përmbushin pjesërisht detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin, parë kjo si strukture, si organizim dhe si përbërje të stafit. Në analizën e stafi akademik në njësitë bazë vërehet përsëritje e stafit në module të ndryshme dhe mungesë e theksuar e atij akademik të specializuar në fushën e fiziterapisë. Lëndët karakterizuese të programit mbulohen kryesisht nga personel i pa kualifikuar me gradat e nevojshme. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore përbëhet nga 15 lektor të brendshëm , prej te cilëve vetëm 5 kanë graden “Doktor i Shkencave” te tjerat kane Msc. Pjesa më e madhe e stafit të brendëshëm nuk ka tituj akademike “Profesor” apo “Profesor i asociuar”, më shume se 60% e tyre paraqiten pa grada shkencore. Gjithashtu në përbërjen e tij departamenti ka të përfshirë në mësimdhënie edhe 1 anëtar personel ndihmës akademik me karakter mësimor.</p> <p><i>Evidenca nr. 23. Urdhër i MASR nr. 257, datë 19.07.2021, Për riorganizimin nga program i përbashkët Bachelor në Fizioterapi, në program të ciklit të parë Bc. ne Fizioterapi.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 46. Struktura organike e FSHM.</i></p>




<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Praktika mësimore, kryhet në laboratorin e Fizioterapisë për realizimin e programit të studimit. Gjithashtu KUR liston marrëveshje bashkëpunimi me spitale dhe klinika për realizimin e tyre. Me Urdhër nr 1 datë 20.01.2023 përgjegjësi i departamenti ka emeruar personim përgjegjës duke e angazhuar atë për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj</p> <p><i>Evidenca nr. 63. Urdher i pergjegjesit te departamentit per caktimin e persoletit per praktikat profesionale ne programin Ba. Infermieri dhe Ba. Fizioterapi.</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin Bachelor në “Fizioterapi” kishte caktuar një petagog me titull Msc në rolin e koordinatores të programit të studimit e cila koordinon punën për hartimin e strategjisë së zhvillimit të programit, rregullores së programit, dokumentacionit që përfshin të gjithë elementët e programit dhe praktikat profesionale. Gjithashtu ndjek ecurinë e regjistrimeve dhe transferimeve të studentëve, monitoron realizimin e projekteve.</p> <p><i>Evidenca nr. 5. Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekësore.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht, referuar analizës të dokumentacionit shqyrtues si dhe takimeve me stafin gjate vizitës në ambientet e KUR. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore për programin e studimit Bachelor në Fizioterapi, plotëson kriteret e nevojshme për sa i përket organizimit dhe strukturën akademike, por jo për titujt akademik. Përgjegjësit e programit të studimit në Departamenti I Shkencave Teknike Mjekësore nuk kanë tituj akademike Profesor apo Profesor të asociuar.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi II.3</b>  <b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore në KUR, është përgjegjëse në kryerjen e funksionit si njësisë kryesore, duke patur informacion dhe dokumentat e nevojshme për të gjithë elementet e programit të studimit: rregullore, planet mësimore, numrin dhe ngarkesën mesimore të çdo pedagogu, organizimin e praktikave profesionale, strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, kalendarin e provimeve, etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 5. Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekësore.</i>  <i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në "Fizioterapi", i riorganizuar (2021-2024)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve</p>	<p>GVJ gjykon se programi i studimit është në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Ai është i ndarë në lëndë, module, praktikë dhe aktivitete formuese të cilat zhvillohen në 3 vite akademike, në 6 semestra në total dhe 2 semestra në secilin vit akademik.</p>

<p>në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve, orët në auditor/ jashtë auditorit.</p>	<p>Plani mësimor përfshin informacionin e nevojshëm në lidhje me ngarkesën mësimore, e cila përfshin ngarkesën në orë në auditor dhe jashtë auditorit, që zënë komponentët mësimorë, leksionet, seminarët, laboratorët, praktikat, forma e kontrollit të vazhduar, etj. Orët në auditor dhe orët jashtë auditorit së bashku përbëjnë sasinë mesatare të punës së kryer nga një student gjatë një viti studimi, që është 60 kredite x 25 orë mësimore për kredit 1500 orë mësimore punë të studentit. Programi në total ka 4500 ore në 3-vite akademike.</p> <p>Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, forma të kontrollit të vazhdueshëm është deri në 25 orë mësimore nga 50 minuta secila. Kreditet që i korrespondojnë çdo veprimtarie formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv, në verifikimin perfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhduar me atë perfundimtar. Rregullat për frekuentimin dhe ndjekjen e programit, si dhe vlerësimin e njohurive përcaktohen në rregulloren e programit, si dhe në syllabuset e lëndëve</p> <p><i>Evidenca nr. 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.</i>  <i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në "Fizioterapi", i riorganizuar (2021-2024)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>I gjithë informacioni i nevojshëm që lidhet me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve është pasqyruar në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Bazuar në rregulloren e njësisë kryesore, pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet në fakultet bëhet në bazë të kriterëve që vijojnë :</p> <p>a. Studentë të cilët zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e shkollës së mesme</p> <p>b. Studentë që zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë shtetit por të vlerësuar ekuivalente me atë të shkollës së mesme</p> <p>c. Studentë që zotërojnë një diplomë të lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë kanë mundësi të aplikojnë për tu pranuar në IAL.</p> <p>d. Vërtetojnë me dokumente zyrtar transferimin nga një institucion public ose privat i arsimit të lartë që ushtron veprimtarinë e saj në shqipëri ose jashtë shtetit.</p> <p><i>Evidenca nr. 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Përmbajtja e syllabuseve të lëndëve në program kanë elementët e përcaktuar nga VKM Nr.41 24.01.2018, shtojca nr.2 si: titullari, ngarkesa dhe tipologjia. Metodatat e mësimdhënies dhe formatet e vlerësimit të studentit janë të përshtatshme për çdo lëndë dhe në raporte të dhura sipas lëndës, përmbajnë informacionet e nevojshme të detajuara në lidhje me objektivat e lëndës, tematikat e leksioneve dhe seminarëve, orët brenda dhe jashtë auditorit. <i>Literatura e pasqyruar në syllabuse nuk është e azhurnuar me botime recente.</i> Programet si në strukture dhe përmbajtje, janë të kuptueshme, mund të përballohen nga studentët dhe tu japin atyre një formim bashkëkohor të fizioterapeutit.</p> <p><i>Evidenca nr. 50. Syllabuset e programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim</p>	<p>Me Urdher nr. 258 datë të MASR programi i studimit është riorganizuar në masën mbi 20%. KUR synon të mundësojë përmirësimin e programeve të</p>

dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	studimeve nëpërmjet personelit akademik si dhe të modifikojë kur e shoh të arsyeshme metodologjinë e mësimdhënies për të përmirësuar nivelin e përfitimit nga studentët. <i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në "Fizioterapi", i riorganizuar (2021-2024)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht, referuar analizës të dokumentacionit shqyrtues dhe nga biseda me stafin akademik të gjatë vizitës. Programi i studimit është i ndarë në lëndë, module, praktikë dhe aktivitete formuese të cilat zhvillohen në 3 vite akademike, në 6 semestra në total dhe 2 semestra në secilin vit akademik. Plani mësimor përfshin informacionin e nevojshëm në lidhje me ngarkesën mësimore, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi për programin e ciklit të parë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ ose punësimin e studentëve.	Bazuar në planin mësimor GVJ gjykon se përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive profesionale. Praktikant mësimore zënë mbi 10% të ngarkesës totale të programit. <i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në "Fizioterapi", i riorganizuar (2021-2024)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Plani mësimor përfshin informacionin e nevojshëm në lidhje me ngarkesën mësimore, e cila përfshin ngarkesën në orë në auditor dhe jashtë auditorit, që zënë komponentët mësimorë, leksionet, seminarët, laboratorët, praktikant, forma e kontrollit të vazhduar, etj <i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në "Fizioterapi", i riorganizuar (2021-2024)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Organizimi i programit Bachelor në "Fizioterapi" në Kolegjin Universitar Reald, mundëson kryesisht arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të pritshme të të nxënit që synon ky institucion. Programi është i shpërndarë në 3- vite studimi me 2-semestra secili dhe në total ka 1800 kredite. Programi mësimor është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të marrë dije profesionale teorike dhe praktike në fushën e fizioterapisë. <i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në "Fizioterapi", i riorganizuar (2021-2024)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe	Raporti midis formimit teorik dhe praktik është shprehur në program sipas VKM nr 41. Në vitin e parë dhe të dytë praktika zë rreth 16% të orëve gjithsej (3000-ore dy vitet) duke u dhënë mundësi studentëve të

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 13

<p>praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>praktikojne kujdesin rehabilitues në të gjitha moshat. Në program leksionet zenë rreth 20% të orëve dhe pjesa tjetër (seminare e praktikë profesionale) 80% të orëve. Ky raport shpreh qartë synimin për formim profesional të këtij program studimi. Në këtë këndvështrim mundësohet arritja e objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> <p><i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në "Fizioterapi", i riorganizuar (2021-2024).</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Përmbajtja e syllabuseve të lëndëve në program kanë elementët e duhur të përcaktuar sipas VKM Nr.41 24.01.2018, shtojca nr.2. <i>Nga analiza e syllabuseve të vëna në dispozicion u vune re se, literatura e pasqyruar në to paraqitet shumë e vjetëruar (jo recente). Ajo nuk është azhurnuar dhe vërehet mungesa e literaturës së huaj bashkëkohore.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 50. Syllabuset e programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Program i studimit Bachelor në "Fizioterapi" garanton përfitim të dijeve në fushën e rehabilitimit. Ai synon të pajis studentët me njohuri dhe shprehje komplementare, që do të shërbejnë atyre në punësim. Lëndët e programit mundësojnë formimin bazë rehabilitues, klinik, specific dhe praktik sipas synimeve të përcaktuara.</p> <p><i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në "Fizioterapi", i riorganizuar (2021-2024).</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit mundëson punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës në vendin tonë si dhe i ndihmon ata për studime të mëtejshme të avancuara.</p> <p><i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në "Fizioterapi", i riorganizuar (2021-2024).</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht pas shqyrtimit të dokumentacionit si dhe vizitës në aktivitet. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti i formimit teorik me atë praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor në vendin tonë si dhe me programet ndërkombëtare. Programi i studimit garanton marrjen e njohurive, aftësive dhe kompetencave të synuara në nivelin Bachelor dhe i ndihmon studentet për studime të mëtejshme të avancuara. Gjithashtu ndihmon në rritjen e ambicieve të studentëve për angazhime profesionale drejt tregut të punës. Nga analiza e syllabuseve të vëna në dispozicion u vune re se, literatura e pasqyruar në to paraqitet shumë e vjetëruar (jo recente). Ajo nuk është azhurnuar dhe vërehet mungesa e literaturës së huaj bashkëkohore.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	




**Standardi II.5**

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Në dokumentacionin shqyrtues KUR rendit bashkëpunime me institucione të ndryshme. Këto bashkëpunime synojnë të përgatisin fizioterapist të aftë profesionalisht, në gjendje t'i përgjigjen kërkesave të tregut të punës, duke ju ofruar studentëve fleksibilitet në njohuritë e përftuara në këto institucione. Në përshtatjen ndaj kërkesave të tregut, IAL ofron edhe programe të ciklit të dytë, master profesional në Fizioterapi. Megjithatë ai nuk paraqet një studim të mirefilltë të studimit të tregut të punës dhe të punësuarve nga studentët e diplomuar nga KUR.</p> <p>Evidenca nr. 24. Lista e subjekteve me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave profesionale</p> <p>Evidenca nr. 25. Marrëveshja e bashkëpunimit me Spitalin Rajonal të Vlores.</p> <p>Evidenca nr. 26. Marrëveshja e bashkëpunimit me Spitalin Psikiatrik të Vlores</p> <p>Evidenca nr. 27. Marrëveshja e bashkëpunimit me Spitalin Rajonal të Fierit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë takimeve me stafin akademik dhe student konstatoi se IAL nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre duke i angazhuar dhe në Senat. Ata konsiderohen si një burim i nevojshëm për të marrë sugjerime në funksion të rishikimit të programit dhe rritjes së cilësisë së zhvillimit të procesit teoriko-praktik. Gjithashtu zyra e Karrieres dhe Alumin organizon takime të vazhdueshme me studentët e diplomuar për të dhënë kontributin e tyre në përmirësimin e programit dhe dhënies së informacionit rreth punësimit të tyre.</p> <p>Evidenca nr. 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.</p> <p>Evidenca nr. 77. Te dhena të punësimit të studentëve të diplomuar.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p><b>Nuk u evidentuar asnjë dokument justifikues ku të tregohet se si pasojë e bashkëpunimeve me institucione publike e private IAL përditëson dhe riorganizon programe specifike për nevojat lokale.</b></p> <p>Vizita në Institucion</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konkludon se ky standard <b>përmbyshet kryesisht pas shqyrtimit të dokumentacionit si dhe vizitës në aktivitet. KUR nuk paraqet një studim të mirefilltë të studimit të tregut të punës dhe të punësuarve nga studentët e diplomuar. Gjithashtu nuk u gjet asnjë dukoment ku të tregohet se, njësitë përgjegjëse përditëson apo përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim.</b></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X






### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar ne programin mesimor, GVJ gjykon se KUR garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat e nevojshme. Format e Mësimdhënies jane: leksion, seminar, ushtrimet, labororet, praktika mesimore, detyrat e kursit etj. Rregullorja e programit të studimit përcakton elementët e mësimdhënies në programin e studimit, procesin e vlerësimit dhe testimit të njohurive. KUR ka hartuar dhe rishikuar rregulloret për funksionimin e institucionit sipas rekomandimeve të Bordit të akreditimit, të miratuara nga Senati Akademik me vendim Nr.33, datë 22.04.2020. <i>Evidenca nr. 5. Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekësore.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	GVJ gjykon se stafi akademik në KUR angazhohet për të ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit bachelor në përgjithësi dhe specifikisht per module te vecanta gjithashtu është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. Gjatë të pandemisë, u praktikuan metodat alternative të mësimdhënies/nxënies ku rezultuan relativisht efikase. <i>Evidenca nr. 5. Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekësore.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Personeli akademik gjatë mësimdhënies përdor metoda të ndryshme dhe fleksible për studentët. Mësimdhënia në distancë është një metodë fleksibel që u perdorë gjerësishtë gjatë pandemisë në platformën google classroom. Në parashikimet buxhetore vendos fonde për pasurimin e mësimdhënies. <i>Evidenca nr. 32. Vendimi i Ba per mirtimin e fondit per kerkimin mjeksor.</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<i>Nga informacioni i vënë në dispozicion nga KUR dhe vizita në ambientet e tij u vu re se, personeli akademik nuk ishte me specializimet e kërkua në fushën e programit dhe pa titujt e nevojshem, per të gëzuar njohurite dhe konceptet e duhura në mesimdhënien e programit.</i>  <i>Evidenca nr. 59: CV e stafit akademik</i>
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në	DSHTM përmes vlerësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies, me qëllim përmirësimin e tyre të vazhdueshëm, në funksion të rritjes së efikasitetit të mësimdhënies mbështet studentët si pjesë integrale e përmirësimit të metodologjisë së mësimdhënies. Përmes anketimeve të

mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	zhvilluara merren mendimet e tyre për këtë proces, mendime dhe ide të cilat reflektohen në format e mësimdhënies. Rezultatet e pyetësorit përdoren nga njësia kryesore për hartimin e politikave të përmirësimit në mësimdhënie. <i>Evidenca nr. 30: Kërkesa buxhetore te Keshillit Studentor.</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	GVJ ne analizën e stafit akademik konstatoi në përbërje të tij strukturë ndihmës akademike. Struktura ka organizuar aktivitete të ndryshme informuese mbi mundësitë që u ofrohen personleve akademike për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Përmendim Qendrën kërkimore, te Cilesise dhe Karrieres dhe strukturën e NJSBC. Gjithashtu eshte krijuar figura e koordinatorit duke synuar që nëpërmjet tij të promovohet përmirësimi i vazhdueshëm i mësimdhënies, koordinimi dhe bashkërendimi me njësitë kryesore/ bazë, aktivitetet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.  <i>Evidenca nr. 34: Vendimi per miratimin struktures se sigurimit te Cilesise dhe Keshillitbte Karrieres.</i> <i>Evidenca nr. 87: Plan pune I qendres kerkimore</i> <i>Evidenca nr. 89: Raporti vjetor NJSBC</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion si dhe vizitës në aktivitet. KUR paraqet zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat e nevojshme. Stafi akademik ne KUR nuk ishte me specializimet e kërkuara në fushën e programit dhe pa titujt e nevojshem, per të gëzuar njohurite dhe konceptet e plota në mesimdhënien e programit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### Standardi III.2

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/ Rregulloren e Institucionit/ rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Mënyrat e mësimdhënies në progamin e studimit Bachelor në Fizioterapi janë leksionet, seminarët, labororet, praktika, detyrat e kursit etj. Studentët gjithashtu marrin pjesë në konferenca shkencore edhe pse janë shumë të ralla në IAL. Rregullorja e departamentit përcakton qartësisht sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit dhe të kontrollit të dijeve. Praktika e punës në institucion është konform detyrimeve ligjore lidhur me informimin e studentëve mbi metodologjinë e vlerësimit. Të gjithë studentët informohen në mënyrë të detajuar në orët orientuese, në stendën e fakultetit dhe në faqen zyrtare të KUR. <i>Evidenca nr. 5. Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekësore.</i>

	<i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në "Fizioterapi", i riorganizuar (2021-2024).</i>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/ moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.	Strukturuar e syllabuseve sipas VKM nr.41 përcaktojnë mënyrat dhe metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore për studentët. Syllabuset respektojnë të njëjtin format dhe sikurse rezultoi nga biseda me stafin akademik ato prezantohen në fillim të çdo lënde nga titullari i saj. <i>Evidenca nr. 50. Syllabuset e programit të studimit.</i> <i>Evidenca nr. 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Referuar Rregullores të Departamentit njohuritë e studentëve sipas lëndëve dhe specifikave të tyre, vlerësohen duke u bazuar në vlerësimin për detyra, provim kontrollit të vazhdueshëm, pjesëmarrje aktive në mësim, prezantime projekte dhe provim përfundimtar. Në përfundim të lëndës, çdo pedagog njofton studentët për vlerësimin dhe sasinë e pikëve para hyrjes në provimin final. <i>Evidenca nr. 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.</i>
<b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/ Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	DSHTM zhvillon një proces vlerësimi për metodologjitë e mësimdhënies, që përfshin në të edhe studentët, duke marrë mendimet dhe sugjerimet e tyre. Këto metodologji miratohen nga pedagogët që përfshijnë edhe studentët me ballafaqime të ndryshme për pëtmirësimin e kurrikulave.  <i>Evidenca nr. 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.	KUR mbështet personelin e tij në përdorimin e metodologjive inovatore, që ndihmojnë studentët të përmirësojnë kompetencat e reja dhe të përmbushur kërkesat e tregut të punë dhe kërkesat e punëdhënësve. Personeli akademik gjatë mësimdhënies përdor metoda të ndryshme dhe fleksible për studentët. Mësimdhënia në distancë është një metodë fleksibël që u përdorë gjerësisht gjatë pandemisë.  <i>Evidenca nr. 90 Lista e aktiviteteve të zhvihuara</i>
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion si dhe vizitës në aktivitetet. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen qartë në Rregulloren e programit të studimit. Njohuritë e studentëve sipas lëndëve dhe specifikave të tyre, vlerësohen duke u bazuar në vlerësimin për detyra, kontrollit të vazhdueshëm, prezantime, projekte e provim përfundimtar dhe pjesëmarrje aktive në mësim. KUR mbështet personelin e tij në përdorimin e metodologjive</i>

	<i>inovatore, që ndihmojnë studentët të përmirësojnë kompetencat e reja dhe të përbushur kërkesat e tregut të punë dhe kërkesat e punëdhënësve.</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore i studentëve realizohet sic është parashikuar në rregullore e syllabuse. GVJ gjykon se ka rëndësi edhe komunikimi i drejtëpërdrejtë gjatë procesit mësimor që është efikas. Numri i ulet i studentëve e mundeson këte gjë tek KUR.  <i>Evidenca nr. 50. Syllabuset e programit te studimit.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<i>GVJ kostatoj se institucioni nuk vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</i> <i>Evidenca nr. 8 Rrregullore e Zhvillit te provimeve</i>
<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Bazuar në Rregulloren e Fakultetit te Shkencave Mjekësore, testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë. Titullari i lëndës është anëtar i komisionit të provimeve dhe asistenti i tij. <i>Evidenca nr. 5. Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekësore.</i>
<b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Ne varësi nga natyra e lëndës, pas çdo provimi komisionit të provimit i kërkohet t'i shpjegojë studentit vlerësimin e bërë dhe nëse provimi është edhe në formë të shkruar, të ballafaqojë përgjigjet e studentit me tezën e zgjidhur, duke e ndihmuar të përmirësohet në të ardhmen.  <i>Evidenca nr. 8 Rrregullore e Zhvillit te provimeve</i> <i>Evidenca nr. 65 Provim I korrigjuar me komente</i>
<b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/ nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar për këtë proces vlerësimi dhe vizitën në institucion, <i>GVJ konstatoi se KU Reald nuk kishte një sistem antiplagjiaturë, në të cilin të bëheshin kontrollat për temat e diplomave apo detyrat e kursit që kishin studentët.</i> Gjatë testeve në rast të kostatimeve me kopje apo sugjerime, studentit anulohet provimi. <i>Evidenca nr. 5. Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekësore.</i> <i>Evidenca nr. 8 Rrregullore e Zhvillit te provimeve</i> <i>Evidenca nr. 9. Rrregullore e Diplomimit</i>
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në	Bazuar në Rregulloren e IAL në nenin 58 përcaktohen modalitetet e vlerësimeve. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 20

kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	përkatëse. Pas përfundimit të çdo provimi apo formave të tjera të kontrollit të dijeve, rezultatet bëhen të njohura brenda 3 ditëve nga dita e zhvillimit të tij. Një ditë pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve. <i>Evidenca nr. 4 Rregullore e pergjitheshme</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. <b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Studentët kanë të drejtat për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të pedagogut të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura. Për sqarime të mëtejshme ata kanë të drejtë t'i drejtohen me shkrim Dekanit të Fakultetit. Në rast ankimesi, njësi bazë ngre komisionin e shqyrtimit të ankimit, i cili shqyrton dhe jep vlerësimin përfundimtar për studentin. Komisioni raporton në përfundim të drejtuesit të departamentit.  <i>Evidenca nr. 4 Rregullore e pergjitheshme</i> <i>Evidenca nr. 8 Rregullore e Zhvillit të provimeve</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht pas takimeve në ambientet e KUR. IAL nuk ka një sistem antiplagjiaturë, në të cilin të bëhen kontrollet për temat e diplomave apo detyrat e kursit të studentëve. Gjithashtu nuk vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. Cdo kërkesë apo ankimim i studentëve sa i takon vlerësimit të njohurive, shqyrtohet nga komisioni vlerësimit me procedurë transparente dhe të dokumentuar.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe praktika, përmbajtja e tyre dhe metodat e mësimdhënies krijojnë mundësinë dhe garantojnë thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve. Alternimi i lëndëve të formimit të përgjithshëm me ato të formimit karakterizues apo plotësues i ndihmon studentët të fitojnë dhe zhvillojnë aftësi profesionale në fushat e studimit që ofron ky program studimi, të cilat përforcohen edhe nëpërmjet laboratorëve dhe zhvillimit të praktikës profesionale. <i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në "Fizioterapi", i riorganizuar (2021-2024).</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të	Bazuar në planin mësimor, programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive specifike në fushën e burimeve njerëzore, sociale, të komunikimit

<p>veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>dhe bashkëveprimit. Në kurrikulat e programit të studimit Bachelor në Fizioterapi, studentët zhvillojnë disa lëndë me zgjedhje jo teknike si gjuhe e huaj, etike dhe psikologji. <i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në "Fizioterapi", i riorganizuar (2021-2024).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Nga analiza e syllabuseve vihet re përpjekje për përgatitjen e studentëve me aftësitë dhe kompetencat e paraqitura në programin e studimit. <b>GVJ gjykon se, nevojiten module me te profilizuara dhe literature më recente nga sugjerimet e titullareve te cdo moduli.</b>  <i>Evidenca nr. 50. Syllabuset e programit te studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit konkludoi se mësimdhënia kryhet mbi bazën e kompetencave në mënyrë që t'u ofrojë studentëve mundësinë për të zhvilluar dhe praktikuar njohuritë e marra në laboratorët në dispozicion. Sikurse konstatohet dhe nga dekontacioni i dorëzuar. Gjatë takimeve u konstatua se stafi akademik dhe studentët punojnë bashkë për projekte apo kërkim shkencor, duke mundësuar dhe botimin e punimeve të tyre në organe botimi apo buletine.  <i>Evidenca nr. 4 Rregullore e pergjitheshme</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni shqyrtues vihet re se personeli akademik shpreh disponibilitet për mbështetjen e studentëve për problemet e mbarvajtjes së studimeve. Keto janë detyrim e përgjegjesi që u ngarkon rregullorja e Institucionit. <i>Evidenca nr. 4 Rregullore e pergjitheshme</i> <i>Evidenca nr. 88 Plan pune i kerkimit shkencor</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion si dhe vizitës në aktivitet. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, që zhvillon mësim në programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi" realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/ jashtë strukturës së programit të studimit, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. . GVJ gjykon</i></p>

	se, nevojiten module me te profilizuara dhe literature më recente nga sugjerimet e titullareve te cdo moduli.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi III.5

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Institucioni paraqet një procedurë të qartë të miratuar për provimin final dhe diplomimin studentëve. Kjo procedurë është publike dhe gjendet në faqen elektronike të IAL. Ajo është pasqyruar edhe në rregulloren e përgjithshme. Studenti lejohet të hyjë në mbrojtjen e diplomës, pasi ka fituar të gjitha kreditet e parashikuara në programin mësimor. Kërkesat e diplomimit janë paraqitur në kurrikulat e çdo programi studimi. Sekretaria mësimore i përcjellë me shkresë të veçantë përgjegjësit të departamentit dhe dekanit të fakultetit listën e studentëve që kanë plotësuar detyrimet e programit të studimit. Përgjegjësi i departamentit pas marrjes së listës së studentëve ngre një komision <i>ad hoc</i> , i cili verifikon nëse studentë kanë plotësuar detyrimet e programit të studimit. Pas verifikimit lista e studentëve, që kanë të drejtën e mbrojtjes së tezës së diplomës, i përcillet përgjegjësit të departamentit. Për fitimin e diplomave të ciklit të parë të studimeve parashikohet përgatitja e një teze diplome, të përpunuar në mënyrë krijuese e të pavarur nga studenti. Drejtuesit e temave të diplomës propozohen nga departamenti me miratimin e Rektorit. <i>Nr 9 Rregullore e Diplomimit.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmblyëse.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni u konkludua se programi i provimit përfundimtar të formimit është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi akademik i Njesisë Bazë, propozohet nga drejtuesi i Njesisë Bazë, si dhe miratohet nga Dekani. Në fund të vitit, studenteve u mundësohen nga Institucioni, konsulenca dhe suporti i duhur për të realizuar kërkimin shkencor sa i takon provimit final.  <i>Evidenca nr 9 Rregullore e Diplomimit.</i> <i>Evidenca nr. 45 Udhezues per hartimin e temes se diplomes.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Referuar nenit 21 ne Rregulloren e programit, KUR ka ngritur një komision të posaçme për provimin final në diplomimin e studentëve. Komisioni dhe kryetari i saj miratohet nga Dekani i fakultetit me propozim të përgjegjësit të departamentit dhe përbëhet nga 5 vetë. Në përfundim juria bazuar në vlerësimin e udhëheqësit të tezës dhe rezultatet e arritura të studentit përfshirë të gjitha lëndët, bënë vlerësimin final me note.  <i>Evidenca nr. 7 Rregullore e programit</i> <i>Evidenca nr. 45 Udhezues per hartimin e temes se diplomes</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton	Pas takimeve me stafin akademik GVJ konstatoi se, studentët janë në orientim të vazhduar nga stafi akademik për provimin e diplomës.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 23

dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Stafi akademik i ndihmon studentët për çdo problematikë që ata hasin gjatë përgatitjes për provimin final.  <i>Evidenca nr 9 Rregullore e Diplomimit.</i>
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Gjatë vizitës të laboratoreve GVJ konstatoi se institucioni i krijon mundësinë dhe i asiston me personel akademik dhe ndihmës akademik studentëve për kryerjen e ushtrimeve të praktikës, përdorimit të aparaturave specifike në laborator apo jashtë tij në bazë të temave të praktikës dhe fushës përkatëse të studimit <i>Evidenca nr. 7 Rregullore e programit</i>
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Studenti vlerësohet me notë në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës. Sipas rregullores neni 64, ngrihet një komisionin i cili dëgjon studentin dhe për të marrë vendimin e notës bazohet në 2 komponentë, e para në notën e vendosur nga udhëheqësi i tij dhe e dyta nga referimi i studentit. Ndërsa në Rregulloren e përgjithshme të IAL, në nenin 59 paraqitet e gjithë procedura e ankimit për rezultatin përfundimtar. <i>Evidenca nr 9 Rregullore e Diplomimit.</i>
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti në përfundim të mbarimit të studimeve pranë Kolegjit Universitar Reald, pajiset me listën e notave, suplementin e diplomës dhe diplomën, formati i së cilës është miratuar nga MASR, në përputhje me Dekretin Nr. 10, të datës 30.03.2020.  <i>Evidenca nr. 7 Rregullore e programit</i>
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Studenti në përfundim të studimeve nëpërmjet një kërkesë drejtuar Sekretarise Mësimore, pajiset me dokumentacionin përkatës zyrtar të nevojshëm.  <i>Evidenca nr 9 Rregullore e Diplomimit.</i>
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion si dhe vizitës në aktivitet. Programi i provimit përfundimtar të formimit është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Detyrimi permbylles bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë 3-viteve akademike, duke patur informacion dhe përfshirë të gjitha lëndët në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,  
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Standardi IV.1**

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

**Kriteri 1.** Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

GVJ bazuar në dokumentacionin të vënë në dispozicion, RVB, si dhe guidës në institucion , konstaton se për këtë diplomë studimi Bachelor në “Fizioterapi” institucioni ka një angazhim dhe dëshirë optimale të burimeve njerëzore për të bërë të mundur rekrutim të stafit akademik me përvoja akademike dhe profesionale, por akoma nuk mund të themi që ka një staf me tituj dhe grada sipas Ligjit 80/2015, të Arsimit të Lartë të Shqipërisë, në referencën 85 *Tabela përmbledhëse për aneks RVB për programin Bachelor Fiziopterapi, tab 6.4* vërehet se në diplomën bachelor ka PAE dhe PAK si më poshtë:

Stafi akademik i programit Bachelor ne “Fizioterapi”	Viti akademik 2022-2023	
	PAE	PAK
Prof Dr	1	-
Prof.Assoc	-	2
Dr/PhD	4	1
Msc	9	4
<b>Ne total (21 pedagog)</b>	<b>14</b>	<b>7</b>

Institucioni ka filluar një praktikë pune, sipas dhe rekomandimeve që i janë lënë edhe gjatë akreditimit të MP në Fizioterapi të bëra një vit më parë duke bërë të mundur rekrutim stafi me trajnime përkatëse 14 pedagog efektiv dhe 7 PAK . Institucioni ka filluar një praktikë pune për rekrutime të stafit akademik me përvojë në fushën akademike dhe me specialitetin përkatës, po kështu ka rekrutuar një staf akademik me MSC (Zoja e Këshillit të mirë), e cila luan dhe rolin e koordinatorës për programin Bachelor në “Fizioterapi”, si dhe të një PAE mjeke - fizioterapeute trajnimin përkatës në fizioterapi (SPA.Msc) *por GVJ vëren se këto rekrutime nuk janë të mjaftueshme për realizimin e programit mësimor me cilësi të lartë kryesisht për lëndët profesionale, pavarësisht numrit të pedagogëve (21 pedagog në total ) sipas evidencës 85 Tabela përmbledhëse për aneks RVB për programin Bachelor Fiziopterapi, tab 6.4 , në këtë staf janë pak pedagogët të cilët duhet të mbulojnë lëndë/module profesionale të programit, me eksperiencë praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.*

Stafi akademik që mbulon lëndët bazë dhe lëndët mjekësore ka eksperiencën dhe kualifikimin e duhur për të mbuluar programet e studimit të fushës akademike. Aktualisht ka staf akademik me kohë të

plotë për vitin akademik 2022-2023 ka 21 pedagog, nga të cilët 19 pedagogë të fushës mjekësi dhe 2 Fizioterapi, nga të cilët: 1 Prof, 2 Prof.Asoc, 5 Doktorë shkencash, dhe 13 pedagogë me gradën Master i shkencave.

FSHM zotëron 1 laboratorë të Anatomisë Humane dhe 1 laboratorë të Fizioterapisë (2 staf ndihmës akademik) , të cilët kanë infrastrukturën e duhur dhe hapsirat të mjaftueshme për realizimin e për realizimin e orëve laboratorike dhe praktikave gjatë zhvillimit të lëndëve profesionale.

Institucioni gjithashtu për të rritur cilësinë e realizimit të praktikave ka lidhur marrveshje bashkëpunimi me institucione private të fizioterapisë , si dhe , me një rrjet spitalësh rajonale (Spitali i Vlorës, Spitali i Fierit, Spitali Psikiatrik) dhe Poliklinika e Vlorës.

Bazuar në referencën 85 *Tabela përmbledhëse për aneks RVB* për programin Bachelor Fizioterapi, tab 2 vrehet se në diplomën bachelor ka PAE dhe PAK sipas viteve akademike për 3 vitet e fundit vrehet si më poshtë:

Viti akademik	PAE	PAK	TOTALI
2020-2021	11	7	18
2021-2022	13 + 1 staf ndihmës akademik	7	21
2022-2023	16 + 1 staf ndihmës akademik	6	23

*Por pavarësisht përpjekjeve në vazhdim që ka bërë institucioni për rekrutim të stafit akademik të kualifikuar, GVJ mendon se akoma nuk janë të mjaftueshme burimet njerëzore (staf akademik për lëndët profesionale) për realizimin cilësor të programit të studimit Bachelor në "Fizioterapi".*

*GVJ mendon se Institucioni duhet të ketë objektiv rekrutimin e stafit akademik me grada dhe tituj sipas sipas Ligjit të Arsimit Të Lartë Shqipëtar si dhe të jenë profesionist të fizioterapisë me trajnime, praktikë dhe grada, duke rritur kështu numrin e pedagogëve të brendshëm për lëndet profesionale në diplomën Bachelor në Fizioterapi.*

*Evidenca 85 Tabela përmbledhëse për aneks RVB për programin Bachelor Fizioterapi, tab 2, 6.4*

*Evidenca nr. 59: CV e stafit akademik të programit mësimor.*

*Evidenca nr. 94: Laboratorët e KUR.*

*Vizita në institucion*

**Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për

GVJ bazuar në evidencën 85 dhe tabelat përkatëse konstaton se personeli akademik me kohë të plotë mbulon **Bazuar në evidencën 85 Tabela përmbledhëse për aneks RVB për programin Bachelor Fizioterapi, Tab 4** mbi ngarkesën mësimore sipas stafit PAE/PAK për programin

programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Bachelor në Fizioterapi është si më poshtë :

Viti akademik 2022-2023	Ore PAE	Ore PAK	TOTALI	
VITI I	672	48	720 orë	
VITI II	660	60	720 orë	
VITI III	576	144	720 orë	
TOTALI	1908	252	2160	

GVJ sic vren në evidencat përkatëse se PAE mbulojnë 70% të ngarkesës mësimore për programin e studimit Bachelor në Fizioterapi sipas ligjshmërisë së arsimit të lartë shqiptar. Shpërndarja e ngarkesës mësimore është sipas legjislacionit në fuqi Udhëzimin Nr. 29, datë 10/09/2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL, **por duhet theksuar se ngarkesa e koordinatorës për lëndët profesionale(324 ORË) është shumë e lartë dhe në këto kushte pavarësisht raportit PAE(1908 ore)/ PAK(252 ore ), ritheksojmë që duhet rekrutuar staf profesionist të fizioterapisë, me trajnime, përvoj akademike në këtë fushë.**

*Evidenca 85 Tabela përmbledhëse për aneks RVB për programin Bachelor Fiziopterapi, tab 4*

*Vizita në institucion*

**Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimin me zyrën e burimeve njerëzore konstatoi se, institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik efektiv të cilat janë të përfshira në Rregulloren për rekrutimin e personelit akademik .

Pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore ishte i gjithë dokumentacioni në lidhje me stafin akademik, atij ndihmës akademik dhe administrativ. Sipas burimeve njerëzore punohet sipas Rregullores se rekrutimit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrative. Model rekrutimi nga GVJ u vu në dispozicion një procedurë rekrutimi pedagog efektiv si më poshte: Departamenti ne baze te nevojave per staf , bazuar ne programin dhe ngarkesen mesimore paraqet ne dekanat kerkesen per staf , ku percakton kriteret preferenciale , ndersa institucioni percakton kriteret e pergjitheshme, pastaj percillet kerkesa ne Rektorat më pas Burimet njerëzore e shpallin në faqen zyrtare: unireal.edu.al, kërkesën për këtë vend pune ( me afatin e dorezimit te dokumentave, listën e dokumentave, kriteret preferenciale dhe kriteret e pergjitheshme), i gjithë dokumentacioni dergohet ne institucion me poste; Zyra e burimeve njerëzore pas mbarimit te afatit te pranimit te dokumentave postare, hap zarfin dhe liston dokumentat per secilin kandidat. Institucion ngre një komision Ad-Hoc me 3 anatar ( 1 shefi i departamentit, 1 nga departamenti, dhe 1 nga burimet njerëzore). Komisioni vlereson te gjitha dosjet duke perpiluar nje table , behet rankimim dhe pastaj kalohet ne intervisten gojore 70% ka dosja dhe 30% intervista. Pas shqyrtimit të dosjeve, intervistës shpallet fituesi i cili i dërgohet rektoratit për vazhdim procedure dhe lidhje kontrate. Burimet njerëzore informojnë të gjithë kandidatët,

	<p>fitues dhe jo fitues për rezultatet e konkurimit.</p> <p>Dosja permban (CV, fotokopje e ID, raporti mjeko ligjor (i aftë për punë), lista e notave, diplomës, gradës, gjuhës së huaj (diplomuar në ZKM), punime shkencore, dy referenca, kontrata e lidhur me institucionin.</p> <p><b><i>GVJ te kontrata që ne kontrolloam të pedagogut të rekrutuar ishte paafat, ndërkohë që duhet të përsëritet cdo vit kontrata për 5 vjet rresht, sipas ligjit të arsimit të lartë.</i></b></p> <p><i>Evidenca nr. 83: Model kontratë pune e stafit akademik me kohë të plotë.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 84: Model kontratë pune e stafit akademik me kohë të pjesshme.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me drejtues të institucionit, dekan, rektor, shef departamenti, koordinator si dhe zyrën e burimeve njerëzore u informua për procedurën e rekrutimit të stafit si më poshtë: Përpara fillimit të vitit akademik, IAL bazuar në nevojat e njësive kryesore dhe njësive bazë bënë shpalljen publike, duke informuar të interesuarit për shpalljen e vendeve vakand, apo për shtim të personelit akademik për vitin akademik në vazhdim, duke përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe ato specifike, sipas kualifikimeve për çdo program. Njoftimi bëhet publik në faqen zyrtare të KUR - Kolegji Universitar "Reald". Në nivel njësie kryesore ngrihet grupi i punës për ndjekien e procedurave të rekrutimit të stafit. Praktika e rekrutimit fillon me propozimin e përgjegjës të departamentit drejtuar Dekanit të Fakultetit, i cili ia përcjell kërkesën Rektorit për ta miratuar atë në Senatit Akademik. Duke qenë se rekrutimi i stafit ka efekte financiare, vendimi i SA i përcillet Bordit të Administrimit, i cili bënë miratimin e numrit të përgjithshëm të stafit akademik që do të rekrutohet, sipas nevojave të njësive në IAL. Pas miratimit të numrit të stafit akademik që do të rekrutohet, grupi i rekrutimit fillon procedurat për rekrutim nën drejtimin e përgjegjës të Zyrës së Burimeve Njerëzore (ZBNj), sipas procedurave të parashikuara në Rregulloren e ZBNj.</p> <p>Kërkesa e përgjegjës të njësisë bazë drejtuar Dekanit të fakultetit për rekrutim stafi akademik me kohë të plotë për vitin akademik, në të cilën përcaktohen nevojat për staf dhe kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët. Kërkesë e Dekanit drejtuar Rektorit për rekrutim stafi akademik me kohë të plotë për vitin akademik.</p> <p>Rektori e propozon në senat, pastaj me vendim senati për miratimin e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë, miratohet nga BA(bordi i administrimit). Pastaj bëhet njoftim publik në faqen e IAL dhe në media, për çeljen e procesit të aplikimit për rekrutim stafi akademik me kohë të plotë, duke përcaktuar numrin, kriteret formale, datën e dorëzimit të dokumentacionit, dhe datën e intervistës Urdhër i Rektorit "Për ngritjen e Komisionit të Rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë".</p> <p>Vlerësimi bëhet në një tabel pikëzimi (70 % dosja dh 30% intervista) dhe komisioni AD-Hoc i zgjedhur nga dekani del me Vendimin e Komisionit të Rekrutimit dhe pastaj bëhet shpallja e listës fituese të aplikantëve për staf akademik. Miratohet me Vendim nga Rektorit për emërimin në detyrë të stafit akademik me kohë të plotë dhe lidhet kontrata. Po kështu ju bëhet me dije dhe kandidatëve jo fitues , arsyet etj.</p>

	<p><i>Evidenca nr. 15. Rregulloren e Zyrës së Burimeve Njerëzore</i>  <i>Evidenca nr. 74: Praktikë rekrutimi e stafit akademik</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion vuri re se, në ambientet e IAL janë në dispozicion për studentët laboratore të paisur me aparatura bashkëkohore (ultratingull, diatermi, TENS, lazer terapi etj) dhe hapsira -bokse të mjaftueshme llogaritur me numrin e studentëve që ndihmojnë për realizimin e orëve laboratorike, për realizimin e projekteve apo kërkimeve të ndryshme detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike. Theksojme se ky laborator përdoret edhe nga studentët e MP, dhe donim të theksonim se bazuar në një rekomandimet e dhëna një vit më parë në akreditimin e MP në KUR, për përmirësimin e laboratorit, ishte realizuar shumë mirë me mungesa të vogla në paisje (topa rehabilitimi, pasqyrë për posturat, llastiqe elastike me rezistenc të ndryshme, shkallët suedeze).</p> <p><i>Evidenca nr. 94: Labororet në IAL</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me drejtues të institucionit, dekan, rektor, shef departamenti, koordinator si dhe zyrën e burimeve njerëzore u informua se KUR mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, të cilët janë sfat i njësisë bazë me kohë të plotë, ose staf me kohë të pjesshme në KUR. Institucioni mbledh, ruan angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrative, dhe kjo praktikë e ndihmon për planifikimin për staf akademik dhe ndihmës akademik për vitin e ardhshëm si dhe është tregues i performancës së tyre.</p> <p><i>Evidenca nr. 55: Të dhëna mbi stafin akademik të programit të studimit në tre vitet e fundit.</i>  <i>Evidenca nr. 57. Ngarkesa mesimore e stafit akademik Bachelor në Fizioterapi - viti akademik 2021-2022.pdf</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB, evidencat e vëna në dispozicion nga Kolegji Universitar Reald (KUR), konstaton se ky institucion ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi, me institucione shëndetësore dhe private për realizimin e praktikave mësimore si: Spitali i Vlorës, Spitali i Fierit, Spitali Psikiatrik Vlorë , etj). KUR ka marrëveshje bashkëpunimi dhe me institucione arsimore të larta brenda dhe jashtë vendit si; Universiteti Mjekësor, Tiranë Universiteti Ismail Qemali, Vlorë , Universiteti i Salernos, Itali. Ka patur marrëveshje bashkëpunimi edhe me Universiteti i Foggias, Itali, por është ndërprer bashkëpunimi që para dy vjetëve.</p> <p>Marrëveshjet e bashkëpunimit janë domosdoshmëri që programi i studimit Bsc në Fizioterapi të realizoj objektivat e tij akademike falë bashkëpunimit me institucione të tjera arsimore dhe shëndetësore rehabilituese të cilat ofrojnë programe Fizioterapie, me qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkëmbimin e eksperiencës akademike.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore / zhvillimore.</li> <li>▪ Mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programeve Erasmus.</li> <li>▪ Realizimin e planit mësimor: praktika klinike, leksione nga personeli shëndetësor.</li> <li>▪ Leksione të hapura.</li> <li>▪ Kërkim shkencor në fushën e shëndetit dhe rehabilitimit.</li> </ul> <p><i>Evidenca nr. 25: Marrveshja me Spitalin Rajonal të Vlorës.</i>  <i>Evidenca nr. 26: Marrveshja me Spitalin Rajonal të Fierit.</i>  <i>Evidenca nr. 27: Marrveshja me Spitalin Psikiatrik të Vlorës.</i>  <i>Evidenca nr. 28: Marrveshja me Salernos, Itali.</i>  <i>Evidenca nr. 29: Marrveshja me Universitet "I.Qemali", Vlorë dhe me Universitetin e Mjekësisë Tiranë.</i>  <i>Evidenca nr. 108: Leksion i hapur "Mbrojtja e jetës dhe shëndetit nga veprat penale".</i>  <i>Evidenca nr. 109. Leksion i hapur "Profesionet e rregulluara dhe procedura ligjore për marrjen e licencës së ushtrimit të profesionit".</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>								
<b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve/ raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	GVJ në takimin me studentët , koordinatoren dhe shefen e departamentit, konstaton se studentët e programit Bachelor në Fizioterapi në orët e praktikës klinike janë të mirëpritur në institucionet shëndetësore publike dhe private , sipas marrëveshjeve të realizuara nga institucioni KUR. Në këto ambiente priten nga mbikqyrësit , të cilët monitorojnë praktikën e studentëve dhe në fund të praktikës bëjnë një vlerësim të performancës së studentëve e cila ndihmon në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale . Ky formular i dorëzohet koordinatores së programit për të bërë më pas vlerësimin e praktikës me notë nga komisioni i provimit. <i>Evidenca nr. 67: Protokoll i praktikës profesionale</i> <i>Vizita në institucion</i>								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ mendon se ky standart "përmbushet kryesisht", pasi në informacionet e mbledhura (evidenca, RVB, vizita në institucion) konstatohet se ka pamjaftueshmëri për personel akademik që mbulon programin e studimit, në përputhje me fushën e programit Bachelor në fizioterapi, dhe si e tillë nuk siguron standarde të mësimdhënies të programit të studimit.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e	GVJ gjatë vizitës në institucion, bazuar dhe në dokumenta të vëna në dispozicion, mendon se ky institucion siguron mjediset e përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimore teorike (auditorë për

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 31

<p>veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>leksione, seminare), hapsira që përputhen me numrat e studentëve në programin Bachelor në Fizioterapi (numri i studentëve në tre vite së bashku me transferimet shkon afërsisht 30 studentë). Sallat e leksioneve, seminareve kanë infrastrukturën e duhur vidioprojektorë, tavolina, karrige, system ngrohje -ftohje etj. Po kështu në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit, Bachelor në Fizioterapi institucioni ka siguruar një kabinet fizioterapie në katin e dytë. Kabineti është i paisur me 9 shtretër, 9 bokse dhe një sërë aparaturash bashkëkohore (lazer terapi, diatermi, ultratingull) etj që ndihmojnë në realizimin e praktikave lëndore, laboratoreve të lëndëve profesionale në Bachelor në Fizioterapi</p> <p>GVJ, lidhur me këtë kriter, konstaton se përmbushet plotësisht , pasi edhe në akreditimin e vitit 2022 për MP Fizioterapi , janë lënë disa rekomandime, specifikisht rekomandimi 8- <i>Paisja e nje kabinetit modern për realizimin cilësor të planit mësimor</i> dhe , ky rekomandim mendojmë se është plotësuar. Përveç laboratorit të fizioterapisë ka laboratorin e kimisë, laboratorin IT, laboratorin e anatomisë etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 85: Tabelat permbledhese per Aneks_RVB përprogramin BSc. Fizioterapi 2022. (Tabela 16)</i></p> <p><i>Evidenca 94: Labororet në IAL.</i></p> <p><i>Vizitë në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë inspektimit të institucionit, GVJ konstatoi se në këtë institucion ka ambiente fizike të mjaftueshme në m<sup>2</sup> dhe të paisura me vidioprojektor, njësi kompjuterike të cilat ndihmojnë në realizimin e procesit mësimor. Mjediset për zyra të stafit të brendshëm akademik kanë gjithashtu hapësirë të bollshme. Po kështu edhe stafi administrativ ka zyrë, kompjuterin e vetë dhe pajisje komode të nevojshme për të realizuar punën e tij. Në të gjitha zyrat për pedagogët kanë akses në internet, gjithashtu ka edhe një sallë me akses interneti në dispozicion të studentëve.</p> <p><i>Evidenca nr. 96: Rack-u i lidhjes në rrjet dhe laborator i informatikës.</i></p> <p><i>Evidenca 94: Labororet në IAL.</i></p> <p><i>Vizitë në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Labororët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Institucioni siguron sipas GVJ-së, hapsirat, auditoret, labororet të cilat ndihmojnë në realizimin cilësor të programit mësimor jo vetëm të pjesës teorike por edhe praktike-laboratorike. IAL ka në infrastrukturën e tij disa laborator si laboratorin i: kimisë, farmacisë, anatomisë, fiziologjisë, fizioterapisë, informatikës, stomatologjisë etj</p> <p>Gjatë takimit me studentët , GVJ u informua dhe konstatoi se , studentët kanë në dispozicion labororet e ndryshëm sipas specifikave të lëndëve dhe bibliotekën . Biblioteka është një strukturë e rëndësishme e KUR dhe për të punohet pa ndërprerje për të siguruar prurje të reja librash e periodikësh nga Universitete të huaja me të cilët ka bashkëpunime dhe kontakte institucionale.</p> <p><i>Evidenca nr. 94: Labororët në IAL</i></p> <p><i>Evidenca nr. 95. Lista e librave ne fushen e shkencave mjekesore qe ndodhen ne Bibliotenen e IAL..pdf</i></p>



	<i>Vizitë në institucion</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se, IAL disponon një kabinet të informatikës, i cili ishte i plotësuar me tavolina kompjuteri si dhe kompjutera për cdo tavolinë, të cilët kishin programe profesionale të instaluar në ndihmë të realizimit të programit mësimor për studentët e program Bachelor Fizioterapaj, por jo vetëm por dhe për studentët e diplomave të tjera dhe stafin pedagogjik.  <i>Evidenca nr. 95: Rack-u i lidhjes në rrjet dhe laborator i informatikës.</i> <i>Vizita në institucion</i>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se KUR, vë në dispozicion të studentëve dhe të stafit akademik, ndihmës akademik , administrativ, mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimor teorik të programit të studimit Bachelor në Fizioterapi dhe si për për formimin praktik- profesional , të këtij program studimi .			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.3

**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe dokumentave të vëna në dispozicion, konstatojnë se në IAL ka një bibliotekë të pasur me rreth 2500 libra on-line për të gjitha diplomat e studimit , por vetëm 174 libra fizik mjekësor për lëndet baze si <i>(anatomji, fiziologji, biomekanike, histologji, sëmundje të brendshme, reumatologji etj)</i> të cilat përbëjnë rreth 70- 80 % të programit mësimor, nga të cilët vetëm 30 janë në gjuhë të huaj. <i>Librat profesional të fizioterapise, të cilat përbëjnë 20-30% të programit janë në formë të cikël lexionesh dhe disa librave por kanë nevoj për shtimin e librave fizike profesional.</i>  Gjithashtu IAL ka një bibliotekë on line të cilat kanë krijuar marrëveshje bashkëpunimi me ABB të Kosovës (uniral.edu.al/biblioteka) e cila të lejon të shfrytëzosh për literaturë libra për mjekë dhe botime të ndryshme për mjekët në gjuhë të huaj.  <i>KUR, ka të akorduar një fond për bibliotekën fizike dhe on line me literaturën e lëndëve profesionale për programin e studimit Bachelor në Fizioterapi, MP në Fizioterapi, me literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj që t'i përshtatet programit specifik të fizioterapisë.</i>  <i>Evidenca 6.1. Kerkese per blerje libra dhe instrumente per Kabinetin e Fizioterapise.pdf (dokumenti shtesë i kërkuar nga GVJ)</i>  <i>Evidenca nr. 95: Rack-u i lidhjes në rrjet dhe laborator i informatikës</i> <i>Evidenca nr. 96: Lista e librave në fushën e shkencave mjekesore që ndodhen në Bibliotekën e KUR.</i>

	<p><i>Evidenca nr. 97: Biblioteka on-line, lista e librave të disponueshëm në bibliotekën e KUR.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>									
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimit me punonjësit e zyrës së karrierës, të bibliotekës dhe punonjësin e IT, u informua se, në fillim të vitit akademik stafi akademik rishikon dhe përditëson literaturën bazë dhe atë të rekomandueshme të lëndëve apo moduleve që do të zhvillojnë, nëpërputhje me zhvillimet që ndodhin në fushën e studimit, për këtë literaturë planifikohet edhe buxheti përkatës. Nga drejtuesit e KUR u informua fondi për kërkim shkencor dhe bibliotekën është rreth 26.000 Euro, që do të duhet të shpenzohet për literaturës me botime të viteve të fundit dhe kërkimin shkencor.</p> <p><i>Evidenca nr. 50: Syllabus.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 90. Raport vjetor i kërkimit shkencor për vitin akademik 2021-2022..pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>									
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>IAL, Kolegji Universitar "Reald" në Vlorë, në infrastrukturën e institucionit ka një bibliotekë institucionale, për të gjithë studentët e programeve të studimit që janë në këtë Kolegj.</p> <p>Biblioteka fizike është me një larmi literature, rreth 2500 copë libra nga të cilat 500 copë janë blerë në Qershor 2020, 174 libra fizik mjekësor për lëndët bazë por për diplomën Bachelor Fizioterapi, specifikisht për lëndët profesionale numri i librave fizik është me i pakët, por KUR ka akorduar një fond për blerjen e librave profesional dhe pasurimin e bibliotekës fizike të institucionit.</p> <p>Biblioteka funksionon edhe on-line, por përsëri kishte shumë pak literaturë për studentët dhe pedagogët e Bachelor Fizioterapi. Biblioteka shfrytëzohet nga çdo student dhe pedagog edhe fizikisht edhe on-line në çdo kohë, falas.</p> <p><i>Evidenca nr. 96: Lista e librave në fushën e shkencave mjekësore që ndodhen në Bibliotekën e KUR.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 98: Lista e librave të rinj të shtuar në Bibliotekën e IAL për periudhën 2020-2021.</i></p> <p><i>Ref. Vizita në institucion</i></p>									
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ sic e përmendëm dhe në standartet e mësipërme gjatë vizitës në institucion si dhe dokumentave të vëna në dispozicion, konstatoi se në IAL ka një bibliotekë të pasur me rreth 2500 libra on-line për të gjitha diplomat e studimit, por vetëm 174 libra fizik mjekësor për lëndët bazë, por mungojnë librat profesionalë të cilat duhet të përshtaten sipas lëndëve në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Pasqyruar këto edhe në Statut dhe Rregulloret e Fakultetit dhe programit.</p> <table border="1"> <tr> <td>A</td> <td>Lëndë Baze</td> <td>5% - 10% (Kredite)</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>Lëndë Karakterizuese</td> <td>30% - 40% (Kredite)</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese</td> <td>20% -30% (Kredite)</td> </tr> </table>	A	Lëndë Baze	5% - 10% (Kredite)	B	Lëndë Karakterizuese	30% - 40% (Kredite)	C	Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese	20% -30% (Kredite)
A	Lëndë Baze	5% - 10% (Kredite)								
B	Lëndë Karakterizuese	30% - 40% (Kredite)								
C	Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese	20% -30% (Kredite)								

	D	Lëndë Plotësuese	10% (Kredite)
	E	Detyrime Përmbyllëse	10%-20% (Kredite)
	<p>Gjithashtu GVJ konstaton se KUR ka bërë kërkesa për pasurimin e bibliotekës me libra fizik për lëndët profesionale bazuar në Evidence 6.1. Kerkese per blerje libra dhe instrumente per Kabinetin e Fizioterapise. (dokumenti shtesë I kërkuar nga GVJ)</p> <p><i>Evidenca nr. 96: Lista e librave në fushën e shkencave mjekësore që ndodhen në Bibliotekën e KUR.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 98: Lista e librave të rinj të shtuar në Bibliotekën e IAL per periudhën 2020-2021.</i></p> <p><i>Ref. Vizita në institucion</i></p>		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion u informua se studentët dhe pedagogët që janë pjesë e IAL-së, kanë të drejtë pa pagesë dhe pa asnjë pengesë të shfrytëzojnë bibliotekën fizike cdo ditë pune (edhe të shtunën), me përjashtim të ditëve pushim dhe ditëve festive zyrtare dhe biblioteka on-line në cdo kohë.</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>		
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	<p>GVJ gjatë vizitës në bibliotekë konstatoi se , IAL ka një bibliotekë on line të cilat kanë krijuar marrëveshje bashkëpunimi me ABB të Kosovës (uniral.edu.al/biblioteka) e cila të lejon të shfrytëzosh për literaturë libra për mjekë dhe botime të ndryshme për mjekët në gjuhë të huaj. Po ashtu u vu re se ekziston një hapsirë e mjaftueshme dhe infrastrukturë kompjuterike, programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, për të bërë të mundur shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët dhe stafin akademik.</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>		
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	<p>GVJ mendon se biblioteka ju vihet në dispozicion studentëve dhe pedagogëve të Kolegjit Universitar “Reald”, në orare të ndryshme që nuk pengojnë procesin mësimor. Biblioteka fizike është në dispozicion të studentëve dhe të stafit cdo ditë pune (edhe të shtunën) , me përjashtim të ditëve pushim dhe ditëve të festave zyrtare , ndërsa biblioteka on-line në cdo kohë .</p> <p><i>Ref. Vizita në institucion</i></p>		
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të	<p>Në takimin me drejtuesit e KUR, zyrën e NJSBC , zyrën e karrierës dhe të bibliotekës u informuam se biblioteka pasurohet periodikisht me literaturë fizike në funksion të programev të studimit, në përputhje me kërkesat që ka stafi akademik planifikohet dhe buxheti përkatës. Aktualisht Bibloteka on-line ofron një gamë të gjerë librash dhe botimesh të ndryshme në gjuhën angleze. Ato mund të lexohen on-line në linkun unireal.edu.al/bibliotekë.</p> <p>GVJ sic përmendi dhe më lartë konstaton se nuk ka libra fizik profesional të domosdoshëm për studentët që zhvillojnë programin Bachelor në Fizioterapi.</p> <p>Më poshtë jepen lidhjet për aksesimin e bibliotekës on-line:</p>		

studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Libra për mjekë: <a href="http://www.freebooks4doctors.com/f.php?f=hiv">http://www.freebooks4doctors.com/f.php?f=hiv</a> Botime për mjekë: <a href="http://www.freemedicaljournals.com/">http://www.freemedicaljournals.com/</a> . <i>Evidenca nr. 97: Biblioteka on-line, lista e librave të disponueshëm në bibliotekën e KUR.</i> <i>Evidenca nr. 98: Lista e librave të rinj të shtuara në Bibliotekë Vizita në institucion</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ mendon se ky standart "Përbushet Plotësisht" pasi ,KUR ka mjediset mbështetëse të mësimnxënies, si bibliotekën fizike dhe on-line, e cila ka literaturë të nevojshme dhe të përditësuar për lëndët e formimit bazë kryesisht, bazuar dhe në syllabuset sipas kurrikulës(70-80%) jane literatur fizike per lende te formimit baze,dhe 20-30% literature fizike per lendet profesionale <b>Bachelor në Fizioterapi.</b></i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>GVJ konstaton se institucioni KUR ka një sistem menaxhimi dhe bashkëveprimi nëpërmjet zyrës së IT, bazuar në <i>Referencën 85 Tabela përmbledhëse për aneks RVB për programin Bachelor Fiziopterapi, tab 14 mbi të dhëna të plota për platformën on line (SMM-sistem i menaxhimit të informacionit info.unireald.edu.al)</i>, në këtë sistem menaxhimi elektronik dhe sekretarisë që hedh të dhënat, pedagogët hedhin të dhënat. Sipas Ligjit 80/2015, në rregullores se përgjithshme, neni 52 sanksionohet Dokumentacioni mësimor dhe Baza e të dhënave të Studentëve. Gjatë vizitës në institucion, GVJ-së ju vunë në dispozicion nga sekretaria mësimore e FSHM në formë të shkruar për Programin e studimit Bachelor në Fizioterapi: regjistri themeltar i studentëve, nga koha e regjistrimit, crregjistrime, transferime etj. regjistri me të dhënat akademike (notat sipas lëndëve). GVJ konstatoi se mungonte nr i matrikullimit të studentëve të huaj të regjistruar për vitin akademik 2021-2022 dhe vitin akademik 2022-2023, por për këta studentë i është kërkuar QSHA për të sjell informacionin e duhur për matrikullimin e tyre.</p> <p>Të gjitha të dhënat e paraqitura në këto rregjistra arkivohen në arkivat e shtetit (dosjet e regjistrimit të studentëve, me dokumentacion sipas udhëzimeve të përvitshme të MASR, procesverbalet me rezultatet e testimeve të njohurive të studentëve. <b>GVJ konstatoi se existonin procesverbale të notave në gjuhë të huaj (italisht) për studentët e huaj (italian), ndërkohë që në RVB thuhet se mësimi bëhet në gjuhën shqipe, pasi është prishur marrveshja me Universitetin e Fogias në Itali.</b></p>

	<p>IAL ka ndërtuar dhe aktualisht po implementon një sistem elektronik të komunikimit të brendshëm: platformën SMI (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit) (<a href="https://unireald.edu.al/user/login">https:// unireald.edu.al/user/login</a>), në të cilin kanë akses pedagog, studentët dhe sekretaria.</p> <p>GVJ në takimin me studentët u informua se, cdo student ka portofolin e vet elektronik në të cilën në mënyrë konfidenciale rregjistrohet në lëndët që dëshëron të frekuentojë gjatë semestrit apo në provime në sezonin e vjeshtës dhe sheh arritjet e tij akademike, të hedhura në platformë nga pedagogët e lëndës.</p> <p>Nëpërmjet këtij sistemi, sekretaria mësimore nxjerr në kohë reale vërtetimet e studentëve dhe përparimin akademik të çdo kohe.</p> <p>Pedagogët në sistemin kanë akses për të hedhur: detyrat, provimet e lëndës, vlerësimet e studentëve, leksione on-line. Studentët në sistemi kanë akses për të parë: orarin e lëndëve, rregjistrohen në lëndët sipas semestrit, rregjistrohen në provimet e vjeshtës, shohin përparimin akademik, marrin njoftime të ndryshme nga Sekretaria apo stafi akademik, aksesojnë leksione on-line, plotësojnë pyetësorët që ju jepen për anketimin elektronik të IAL.</p> <p>GVJ gjatë takimit me sekretarinë mësimore u informua mbi aksesin që ato kanë në sistemin SMI: Sekretaria Mësimore aktivizojnë llogaritë e studentëve, nxjerrin transkriptet e notave, nxjerrin mesazhet e ponderuara dhe aritmetike, printojnë faturat e arkëtimit për shërbimet që ofron sekretaria, aktivizojnë përmirësimin e lëndëve të kërkuara nga studentët.</p> <p>Zyra e IT ka publikuar Rregulloren e përdorimit të sistemit për pedagogët dhe studentët.</p> <p><i>Referencën 85 Tabela përmbledhëse për aneks RVB për programin Bachelor Fizioterapi, tab 14 mbi të dhëna të plota për platformën on line (SMM -sistem i menaxhimit të informacionit <a href="http://info.unireald.edu.al">info.unireald.edu.al</a>),</i></p> <p><i>Evidenca nr. 78: Regjistrin themeltar të studentëve (AMZA)</i></p> <p><i>Evidenca nr. 79: Regjistrin e arritjeve akademike (notat).</i></p> <p><i>Evidenca nr. 80: Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.(demostrim)</i></p> <p><i>Evidenca nr. 81: Dosje studenti nga rregjistrimi në diplomim.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 82: Procesverbale vlerësimi (notash).</i></p> <p><i>Evidenca nr. 11: Rregullore për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurine të Dhenave Personale.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 12: Rregullore e përdorimit të SMI</i></p> <p><i>Evidenca nr. 13: Rregullore e standardizimit të procedurave për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve.</i></p>
	<p>Vizita në institucion</p>




<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se IAL administron informacionin, dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik dhe ndihmës akademik. Administrimi i cdo dokumentacioni bëhet në formë shkresore dhe elektronike. Bazuar dhe në urdhrin e rektorit për rregulloren e standartizimin të procedurave për hartimin, administrimin e dokumentacioneve zyrtare.</p> <p>Gjithashtu nga IAL bëhet vlerësimi i performancës vjetore me anë të një formulari vetëvlerësimi i cili plotësohet elektronikisht 2 herë në vit , në dy semestra para sezonit dhe ruhet dhe në formë shkresore. Ky formular plotësohet nga stafi akademik, ndihmës akademik sipas rubrikave me radhe: ngarkesë mësimore në bachelor dhe në master, aktivitet shkencor (konferenca, botime, libra të botuar etj), sa diploma ka udhëhequr, trajnime etj</p> <p>GVJ në takim me përgjegjësen e Zyrës së burimeve Njerëzore , e cila kishte pak kohë që ishte larguar në Universitetin e Vlorës me statusin e PAE, u informua se në këtë institucion Zyra e Burimeve Njerëzore, menaxhon dokumentacionin e pedagogëve si: dosjet personale të stafit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme), ndihmës- akademik dhe administrativ përmbajnë diplomat dhe listat e notave, CV, kontratat e punës, procedurat e punësimit dhe çdo dokument tjetër që konsiderohet i rëndësishëm për punësimin në KUR. Dokumentacioni arshivohet dhe ruhet në arkivën e IAL. Për këtë qëllim KUR ka miraturar Rregulloren përkatëse për "Mbrotjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale".</p> <p>Akcesi i studentëve dhe personelit në sistemin e menaxhimit të informacionit të KUR është një akses tërësisht i dedikuar, konfidencial dhe në ruajtje të të dhënave personale.</p> <p>Çdo student ka portofolin e vet elektronik, me akses personal, ku mund të rregjistrohet personalisht dhe të shohë arritjet e tij akademike në mënyrë konfidenciale.</p> <p>Informacionet personale të stafit administrohen në mënyrë konfidenciale nga strukturat e KUR sipas Rregullores për mbrotjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, miraturar me Vendimin nr. 34, datë 09.05.2020, të Senatit Akademik.</p> <p><b>GVJ mendon se pavarësisht se zyra e burimeve njerëzore funksiononte shumë mirë, KUR duhet të ketë punonjësen e zyrës së burimeve njerëzore staf të brendshëm të institucionit.</b></p> <p><i>Evidenca nr. 11: Rregullore për mbrotjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 38: Vendimin nr. 36, datë 04.05.2020, të Senatit Akademik</i></p> <p><i>Evidenca nr. 11: Rregullore për "Mbrotjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale".</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimet me e realizuara konstaton se, IAL nëpërmjet faqes zyrtare <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a> siguron akses për pedagog dhe student për të marrë informacion në cdo kohë gjithshka lidhet</p>

<p>komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>me programin mësimor (kurrikula, orare, stafin pedagogjik, njoftime të ndryshme të IAL-së).</p> <p>Sistemi i menaxhimit të informacionit SMI ka të integruar platformën e-learning, nëpërmjet së cilës pedagogët mund të hedhin çdo lloj informacioni mësimor, të aksesueshëm në llogaritë e studentëve.</p> <p>Llogatitë e studentëve kanë “Këndin e Njoftimeve”, nëpërmjet së cilës marrin njoftime nga sekretaria dhe administrata.</p> <p>Gjithashtu, IAL i siguron çdo studenti postën elektronike: emër.mbiemer@unireald.edu.al</p> <p>Ndërkohë, për një komunikim interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit me studentët, pedagogët dhe sekretaria përdorin llogarinë e KUR në facebook dhe instagram në adresat:  <a href="https://www.instagram.com/universitetireald/">https://www.instagram.com/universitetireald/</a>  <a href="https://www.facebook.com/Universiteti-Real-1493359964292710">https://www.facebook.com/Universiteti-Real-1493359964292710</a>  Vizita në institucion</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>GVJ konstaton se ky sistem menaxhimi ( sitemin SMI) bën të mundur dhe garanton një monitorim në kohë reale të mbarëvajtjes së procesit mësimor. Falë këtij menaxhimi të brendshëm sistemit elektronik bëhet e mundur identifikimi në kohëreale mangësira ose crregullime të mbarëvajtjes së programit mësimor. Cdo student me anë të adresës së tij elektronike dhe pyetësorëve të ndryshëm anonim shpreh mendimet për cdo problematik që mund tëkonstatojë (planin mësimor, infrastrukturën, bashkëveprimin me stafin akademik, ndihmës akademik, administratën, sekretarinë mësimore, mësimdhënien) etj. Kjo bën jo vetëm konstatimin e problematikave, por dhe informimin në kohë reale të drejtuesve të institucionit, si dhe zgjidhjen në kohën e duhur të problematikave të hasura.</p> <p>Vizita në institucion</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ konstatoi se në faqen zyrtare <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a>, janë të publikuara planet mësimore, orare, aktivitete shkencore të IAL-së, orare të ndryshme Bachelor dhe për Master, data e sezonit,departamentet, stafi akademik, rregullore të ndryshme etj.</p> <p>I gjithë informacioni në faqen zyrtare është në gjuhën shqipe , angleze dhe italiane. <a href="https://unireald.edu.al/en/homepage-4/">https://unireald.edu.al/en/homepage-4/</a>  Evidenca nr. 47: Programi mësimor Bsc në Fizioterapi (Syllabysset)  Evidenca nr. 101: Website i FSHM: <a href="https://unireald.edu.al/it/fakulteti-i-shkencave-mjekesore/#fakulteti">https://unireald.edu.al/it/fakulteti-i-shkencave-mjekesore/#fakulteti</a>  Evidenca nr. 102: Website i FSHM – faqja e programit mësimor: Bsc në Fizioterapi. <a href="https://unireald.edu.al/it/fakulteti-i-shkencave-mjekesore/Fizioterapi">https://unireald.edu.al/it/fakulteti-i-shkencave-mjekesore/Fizioterapi</a>  Vizita në institucion</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ mendon se IAL disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional sistem menaxhimi ( sitemin SMI) dhe e vë atë në dispozicion të stafit akademik, studentëve e cila ju shërben për administrimin, informimin dhe monitorimin e aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit Bachelor në Fizioterapi.</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ refruar evidencës nr 91, Raport financiar për programin e studimit BCs në "Fizioterapi" dhe Evidenca nr. 92: Raport financiar vjetor 2021, mendon se Kolegji Universitar "Reald", harton cdo vit një raport financiar mbi kostot e programeve të studimit, harton buxhetin për bibliotekën, infrastrukturën, mbështetjen e personelit akademik dhe aktiviteteve shkencore të universitetit, IAL harton çdo vit raportin financiar. Ky raport financiar hartohet nga zyra e financës së IAL dhe Bordi i Administrimit miraton cdo fond të veçantë për mbështetjen e aktiviteteve të studentëve, apo për aktivitete kërkimore shkencore të stafit.</p> <p><i>Evidenca nr. 91: Raport financiar për programin e studimit BCs në "Fizioterapi".</i></p> <p><i>Evidenca nr. 92: Raport financiar vjetor 2021</i></p> <p><i>Vizitë në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ bazuar referencave përkatëse dhe vizitës në institucion vërehen, se IAL ka një raport financiar të detajuar për mbarëvajtjen e programeve mësimore sipas zërave: mësimdhënie, kërkimin shkencor, pagat e personelit, infrastrukturën, zhvillimin e personelit, mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare etj.</p> <p>IAL sic u shprehëm dhe më lart, harton çdo vit raportin financiar. Zyra e finances administron gjithë dokumentacionin financiar lidhur me këtë kriter.</p> <p><i>Evidenca nr. 91: Raport financiar për programin e studimit BCs në "Fizioterapi".</i></p> <p><i>Evidenca nr. 92: Raport financiar vjetor 2021</i></p> <p><i>Vizitë në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni siguron auditim të brendshëm cdo vit. Zyra e Financës që administron të gjithë aktivitetin financiar, bën cdo vit një raport vjetor, duke pasqyruar me hollësi cdo zë të financës si: realizimin e planifikimeve të bëra në plan buxhetin e vitit, të ardhurat nga tarifa studentore, shpërndarjen e buxhetit për mësimdhënie, kërkimin shkencor, pagat e personelit, infrastrukturën, zhvillimin e personelit etj. Institucioni</p>



	<p>gjithashtu në bashkëpunim me zyrën e financës harton plan buxhetin e vitit të ardhshëm akademik dhe administron gjithë dokumentacionin financiar lidhur me këto kriter.</p> <p><i>Evidenca nr. 91: Raport financiar për programin e studimit BCs në "Fizioterapi".</i></p> <p><i>Evidenca nr. 92: Raport financiar vjetor 2021</i></p> <p><i>Vizitë në institucion</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni(KUR) në bashkëpunim me zyrën e financës, krahas raportit vjetor financiar, dokumenton dhe bën edhe një raport të detajuar mbi koston financiare të një cikël studimi Bachelor për 3 vitet e kaluara . Bazuar në këtë analizë të kostove financiare institucioni planifikon ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të programit të studimit dhe në analizën vjetore, njësitë bazë dhe ato kryesore marrin dijeni mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës dhe planifikimin e buxhetit për vitin pasardhës.</p> <p><i>Evidenca nr. 91: Raport financiar për programin e studimit BCs në "Fizioterapi".</i></p> <p><i>Evidenca nr. 92: Raport financiar vjetor 2021</i></p> <p><i>Vizitë në institucion</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se Kolegji Universitar "Reald" ka 6 programe studimi Bachelor, 4 diploma MP, 3 diploma MSH kështu që larmia e diplomave , numrit i studentëve në tërësi, dëshmon se institucioni ka një qëndrueshmëri financiare, dhe ka kapacitetet financiare të mjaftueshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit.</p> <p>IAL garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, dhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p> <p><i>Evidenca nr. 91: Raport financiar për programin e studimit BCs në "Fizioterapi".</i></p> <p><i>Evidenca nr. 92: Raport financiar vjetor 2021</i></p> <p><i>Vizitë në institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ mendon se ky standart "<b>Përmbushet Plotësisht</b>" mbështetur në referencat, RVB, vizita në institucion se , KUR garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB, evidencat dhe vizitën në institucion (sekretari), konstaton se KUR dhe FSHM kanë hartuar një numër rregulloresh, të bazuara në LAL dhe aktet nënligjore të tij, të cilat mbulojnë çdo aspekt të jetës akademike të studentëve nga rregjistrimi në diplomim.</p> <p>IAL ka procedura të miratuar për studentët që nga marrja e statusit të studentit deri në diplomimin e tyre të parashikuara në rregulloren e miratuar nga Senati Akademik. Gjithashtu, IAL parashikon edhe fond te veçantë për aktivitete të Këshillit Studentor.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në sekretari u informua dhe shikoi rregjistrat e studentëve nga rregjistrimi i studentëve i cili bëhet pranë sekretarisë mësimore, ku ata paraqesin dokumentacionin përkatës sipas udhëzimit të përvitshëm të MAS.</p> <p>Të drejtat dhe detyrimet e studentëve përcaktohen bazuar në LAL nr. 80/2015, në Statutin dhe në Rregulloren e brendshme të IAL.</p> <p>Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në KUR dhe përfundon me marrjen e diplomës përkatëse, si dhe në raste të ndryshme të çregjistrimit të tij, si: bazuar në kërkesën e studentit për çregjistrim në formën e një deklarate të përpiluar para një noteri publik; kanë munguar ose ka humbur kushtet dhe kriteret për të drejtën e studimit; kur dënohet me burgim për një krim të rëndë, me dashje ose përsëritje, Kur braktis pa shkak studimet dhe pa u ndjekur procedurat për ndërprerjen e studimeve; Me urdhër të dekanit, bëhet çregjistrimi për shkelje të rëndë ose të përsëritur të kësaj rregulloreje ose rregulloreve te tjera të KUR.</p> <p>Viti akademik 2021-2022 nga 25 studentë të rregjistruar (kishte vetëm 4 student të çregjistruar (2 shqiptarë dhe 2 italian) me dëshir të studentit dhe ishin student aktiv 21 studente ( 10 italian dhe 11 shqiptar : 4 me maturë shtetërore për herë të parë dhe 7 të ardhur me transferime)</p> <p><i>Evidenca nr. 73: Vendim i BA për miratim fondi për Këshillin Studentor.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 4: Rregullore e pergjithshme, Kreu IX (Neni 69 - 72) &amp; Kreu X (Neni 74 - 85).</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimit me drejtuesit dhe studentët u informua se , KUR me politikat dhe procedurat që ndjek nga hyrja deri në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë e studentët e programit të studimit Bachelor në Fizioterapi. Studenti sipas rregulloreve të KUR ka të drejtë: Të ndjekë leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tij, të përdorë pajisjet, bazën materiale dhe laboratorike për të realizuar programin mësimor, bibliotekën dhe mjediset sportive të KUR</p>

të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese, në përputhje me LAL nr. 80/2015, dhe Statutin e Kolegjit, të përfitojë bursë studimi brenda ose jashtë shtetit kur plotëson kushtet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, Senatit e në marrëveshjet ndër shtetërore ose ndër universitare, të shprehë opinionin e tij për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit me anë të pyetësorëve anonim apo takimeve me koordinatorët e programit, të ankohet për shkelje të rregullave dhe standardeve akademike nga ana e pedagogëve, të mos realizimit të procesit të mësimdhënies, të rregullave të zhvillimit të provimit dhe për vlerësimin e tij të pamërituar, të ankohet për shkelje të etikës akademike, të konfliktit të interesit dhe të çdo rasti tjetër që cenon integritetin e studentit etj.

Ndërsa me Urdhër nr. 464, datë 27.07.2018, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë është bërë riorganizimi i programit në masën 20%, duke u riorganizuar me 180 kredite, në gjuhën shqipe dhe italiane, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Bachelor” në “Fizioterapi”, e përbashkët me Universitetin e Fogias në Itali, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërinstytucional për këtë qëllim. Nga pala italiane, **për dy vjet rresht nuk u nënshkruan** branda afatit protokollit ekzekutive në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit. Për këtë arsye IAL për dy vjet nuk regjistroi studentë në vitin e parë në këtë program studimi. Në këto kushte, me qëllim vijimësinë e zhvillimit të programit “Bachelor” në “Fizioterapi”, IAL bëri riorganizimin e këtij programi sipas *Evidenca nr. 23. Urdhër i MASR nr. 257, datë 19.07.2021, Për riorganizimin nga program i përbashkët Bachelor në Fizioterapi, në program të ciklit të parë Bc. ne Fiziote.pdf duke e organizuar programin e studimit bachelor në Fizioterapi nga program i përbashkët në gjuhën shqipe dhe italiane (që ishte në 2018 ; Evidenca nr. 22. Urdhër i MASR nr. 464, datë 27.07.2018, Për riorganizimin e programit të studimit Bachelor në Fizioterapi, në Kolegjin Universitar Reald.)* në program vetëm në gjuhën shqipe, me 3 vite akademike, me 180 kredite, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Riorganizimi u miratua me Urdhër nr. 257, datë 19.07.2021, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për riorganizimin nga program i përbashkët studimi të integruar të ciklit të parë “Bachelor” në “Fizioterapi”, në program të ciklit të parë “Bachelor” në “Fizioterapi”, në Kolegjin Universitar “REALD”.

*Evidenca nr. 22. Urdhër i MASR nr. 464, datë 27.07.2018, Për riorganizimin e programit të studimit Bachelor në Fizioterapi, në Kolegjin Universitar Reald.*

*Evidenca nr. 23. Urdhër i MASR nr. 257, datë 19.07.2021, Për riorganizimin nga program i përbashkët Bachelor në Fizioterapi, në program të ciklit të parë Bc. ne Fiziote.*

*Evidenca nr. 4: Rregullore e pergjithshme, neni 69.*

*Evidenca nr. 5; Rregullore e Fakultetit, Neni 44 – të drejtat e studentëve.*

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p><i>Vizita në institucion</i></p> <p>GVJ ne takimin me stafin pedagogjik dhe studentet si dhe dokumentat e vena në dispozicion, GVJ u informua dhe konstatoi se, para çdo viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR organizohen “ditët e informimit të maturantëve” në gjimnazet kryesore të qarkut Vlorë dhe qarqet fqinje të cilat përbëjnë burimin kryesor të studentëve që ndjekin studimet në KUR. Staf i ngarkuar për informim organizon takime, shpërndan fletëpalosje, në mediat locale, ku sqarohen të interesuarit me informacionin e nevojshëm për kriteret e pranimit apo për çështje të tjera të lidhura me të. Nga ana tjetër kriteret e përgjithshme dhe ato specifike janë lehtësisht të aksesueshme në ëeb e KUR. Kriteret dhe procedurat përkatëse për ofrimin e programit të studimit janë hartuar në mënyrë që të jenë të kuptueshme, dhe njëkohësisht të aksesueshme, çka i jep procesit transparencë të plotë. Kriteret dhe procedurat janë të aksesueshme online, i bëhen të ditura të interesuarve në zyrën e sekretarisë mësimore në oraret e përcaktuara për sqarime dhe shërbime dhe gjatë këshillimit e orientimit të ofruar nga zyra përgjegjëse në rang fakulteti e institucioni. Në fillim të çdo viti akademik realizohet procedura e regjistrimit dhe transferimit të studentëve sipas udhëzimeve dhe legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të miratuara nga Senati Akademik para fillimit të vitt akademik. Ato dërgohen në QSHA dhe MAS, si dhe publikohen në faqen e KUR. GVJ konstatoi se në propozimin e kuotave parashikohen kuota për student Brenda dhe jashtë vendit (student shqipëtar, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Bosnjë– Hercegovinës), fakultet të dytë, transferime.(vihet re se ka student nga kosova, italia dhe transferime nga IAL publike dhe jo publike)</p> <p><i>Evidenca nr. 39: Vendim i SA per miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni vëren se kriteret, procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, transferimi, njohja e studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku pasi janë të përcaktuara në rregulloret e studimit të Fakultetit dhe departamentit si dhe online në <i>website i programit të studimit</i>. Evidenca nr. 102: <i>website i FSHM – faqja e programit mësimor: Bsc në Fizioterapi</i>. <a href="https://unireald.edu.al/it/fakulteti-i-shkencave-mjekesore/#Fizioterapi">https://unireald.edu.al/it/fakulteti-i-shkencave- mjekesore/#Fizioterapi</a></p> <p>Gjatë intervistës me studentët u konfirmua se institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të tyre. Informacioni është i aksesueshëm nga burime si: sekretaria mësimore, faqja zyrtare (sistemi SMI) dhe QSHA, që japin informacione për çështje të ndryshme: procedurat e pranimit, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, vlerësimit të diplomimit. Të gjitha procedurat e veprimtarive dhe detyrimeve akademike të ndjekjes së programit mësimor Bsc në Fizioterapi të janë shkruar me fjalor të kuptueshëm nga të interesuarit dhe janë tërësisht të publikuara në: <i>website-in e KUR</i>, afishime në sekretarinë mësimore, facebook-un e KUR.</p>

	<p><i>Evidenca nr. 4: Rregullore e përgjithshme, Kreu V "Organizimi i studimeve universitare.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 7: Rregullore e programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 102: Ëëbsite i FSHM – faqja e programit mësimor: Bsc në Fizioterapi. <a href="https://unireald.edu.al/it/fakulteti-i-shkencave-mjekesore/#Fizioterapi">https://unireald.edu.al/it/fakulteti-i-shkencave-mjekesore/#Fizioterapi</a></i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni merr pjesë në fushatat e informimit të organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (open day) E gjithë procedura që nga aplikimi deri te pranimi i studentëve është publike dhe e aksesueshme në ëëbsite-n e institucionit Përpara fillimit të çdo viti akademik, të interesuarit informohen në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, përmes portalit U albania dhe faqes zyrtare të KUR.</p> <p>Çdo vit akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. Informacioni është publik dhe lehtësisht i aksesueshëm në ëëb, në instagram dhe ne facebook-un e IAL:</p> <p><a href="https://unireald.edu.al/studentet/kritere-e-pranimit/">https://unireald.edu.al/studentet/kritere-e-pranimit/</a>  <a href="https://www.instagram.com/universitetireald/">https://www.instagram.com/universitetireald/</a>  <a href="https://www.facebook.com/Universiteti-Real-d-1493359964292710">https://www.facebook.com/Universiteti-Real-d-1493359964292710</a></p> <p><i>Evidenca nr. 111: Kalendari per informimin e nxënësve maturantë2022.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ konkludon se institucioni parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Para fillimit të vitit akademik KUR parashikon kriteret dhe kuota për kandidatët me aftësi të veçanta apo të shtresave të marginalizuara (komuniteti rom dhe egjyptian).</p> <p><i>Evidenca nr. 103: Tabela e kuotave të pranimit për vitin akademik2019 – 2020.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 104: Tabela e kuotave të pranimit për vitin akademik2021 – 2022</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>GVJ, gjatë vlerësimit konstatoi se KUR, harton dhe publikon kriteret dhe kuota dhe përzgjedhjen për kandidatët brenda vendit dhe nga shtetet e tjera. Institucioni informon përmes faqes zyrtare kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera përmes kuotave të vecanta, gjithashtu institucioni para cdo viti akademik planifikon kuota sipas programit, infrastrukturës së institucionit, nr të stafit akademik pastaj propozimet nga dekanati , kalojnë në rektorat dhe miratohen në senat dhe dërgohen për miratim në MAS. Pranimi i studentëve të huaj bëhet me konkurim të organizuar nga Kolegj Universitar Reald. Studenti i huaj duhet të zotërojë njohjen e gjuhës shqipe, e vërtetur përmes testeve kombëtare.</p> <p><i>Evidenca nr. 7: Rregullore e programit të studimit.</i></p>

	<i>Evidenca nr. 104: Tabela e kuotave të pranimit për vitin akademik 2021 – 2022</i> <i>Vizita në institucion</i>		
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni, takimi me stafin, sekretarinë mësimore, zyrën e burimeve njerëzore, konkludon se në fillimin e çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse të ndihmës ekonomike dhe bursave për shtresat në nevojë, sipas udhëzimeve të ardhura nga MAS si dhe me vendim të Bordit të Administrimit KUR. Bordi i Administrimit parashikon trajtim të veçantë duke aplikuar bursë të plotë apo gjysmë bursë për kategori të caktuara studentësh, si: për studentët ekselentë, për studentët e fëmijëve të punonjësve të rënë në krye të detyrës, për studentët me aftësi të kufizuar, studentë nga komuniteti egjiptian, etj. <i>Evidencë nr. 33: Vendim i Bordit të Administrimit për trajtim të studentëve me status të veçantë.</i> <i>Vizita në institucion</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ bazuar në RVB, guidën në institucion mendon se KUR harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi”.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit të studimit, faqes zyrtare të web si dhe takimit me përfaqësues të tij, GVJ konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore. Gjatë takimit me studentët GVJ konstatoi se ata njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformës online Sistemi SMI. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve si dhe mundësinë e transferimit të studimeve, instrumentat e realizimit të vlerësimit të njohurive për lëndë të ndryshme, komponentët përbërës të vlerësimit total të lëndës, organizimi i provimeve, realizimi i praktikave, diplomimi, ndërpreja dhe rifillimi i studimeve, etj. Studentët informohen edhe nëpërmjet posterave dhe takimet në ditët e hapura me maturanët. Po ashtu në ditën e parë të fillimit të vitit akademik studentët realizojnë takim me drejtues të fakultetit si dhe pedagogë ku ata kanë mundësinë të njohin infrastrukturën, auditorët, të drejtat dhe përgjegjësië, programin e studimit dhe modulet përkatëse etj. Institucioni vë në dispozicion sekretarinë mësimore, Studenti akseson ecurinë akademike

	<p>përmes llogarisë së tij në platformën on line portali i studentit, ku ruhen të dhënat akademike ndër vite dhe studenti informohet për procedurat e përparimit akademik dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Proçedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin janë të përcaktuara saktësisht në Rregulloret e programit mësimor, dhe FSHM (të publikuara në ëbsite), ku qartësisht evidentohet:</p> <p>plani mësimor në 3 vitet e studimit numri i krediteve që i duhet një student të kalojë nga njëri viti akademik në tjetrin, kërkesat e çdo lënde dhe mënyra e vlerësimit (syllabyse), vlerësimi me nota sipas pikëve të marra në të gjitha vlerësimet vjetore, sezonet e riprovimeve: periudha dhe kriteret, detyrimet për marrjen e diplomës</p> <p>IAL publikon kreditet dhe detyrimet penguese për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.</p> <p>Studenti që ndjek programin mësimor Bcs në Fizioterapi mund të regjistrohet on line në lëndët me kode FIZ 2: (në vitin e dytë) vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht 30 ECTS në këtë program studimi, mund të regjistrohet në lëndët me kode FIZ 3: (në vitin e tretë) vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht 80 ECTS në këtë program studimi.</p> <p>Senati akademik herë pas here përditëson rregulla të reja, të cilat publikohen në website-in e IAL dhe u komunikohen studentëve nga Sekretaria mësimore dhe drejtuesit e departamenteve.</p> <p><i>Evidenca nr. 47: Programi mësimor Bsc në Fizioterapi, neni 11.</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>U vlerësua nga GVJ se KUR informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Kjo realizohet nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Sekretaria mësimore pranë njësisë kryesore (fakultetit) dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë informojnë studentët në lidhje me procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p> <p>Kriteret dhe procedurat e njohjes dhe ekuivalentimit të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme i bëhen të ditura studentëve dhe janë pjesë e dokumenteve rregullatore. Studenti i cili dëshiron të transferojë studimet në KUR, informohet për të gjitha procedurat, kriteret që ndiqen në rastin e transferimit të studimeve. Ekuivalentimi i programit nga vjen student i transferuar bëhet nga një komision ekuivalentimi, i përcaktuar nga dekanati dhe me anë të tabelave krahasuese informon studentin për kreditet, lëndët që i njihen dhe çfarë ai duhet të frekuentojë (në institucion nga sekretaria na u vendos në dispozicion një procedurë transferimi e një student nga kosova)</p> <p><i>Evidenca nr. 7: Rregullore e programit mësimor Bsc në Fizioterapi, neni 26 (Kushtet për procedurat dhe modalitetet për transferimin e studentëve).</i> <i>Evidenca nr. 4: Rregullorja e përgjithshme, neni 54, 55 dhe 56</i> <i>Vizita në institucion</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se institucioni disponon dosjen personale (regjistrin) të çdo studenti që njihet me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Po ashtu rregullorja e institucionit parashikon elementet përbërës të vlerësimit dhe peshën specifike të tyre në raport me vlerësimin total, të cilat janë të reflektuara në program/ silabusin e lëndëve. Në fillim të vitit akademik, studentëve u vihet në dispozicion program/s ilabusi i çdo lënde të programit të studimit.</p> <p>Dita e parë në çdo modul i dedikohet sqarimit me studentët të syllabysit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ tematika e lëndës,</li> <li>▪ literatura që do përdoret,</li> <li>▪ mënyra e vlerësimit,</li> <li>▪ kërkesat e pedagogut,</li> <li>▪ rregullat e integritetit akademik.</li> </ul> <p><i>Evidenca nr. 47: Programi mësimor Bsc në Fizioterapi (syllabysset)</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, RVB, guidës në institucion, konstatoi se KUR ka hartuar rregulloren e studimeve. <i>Programi i studimit "Bachelor në Fizioterapi</i> përfundon me provim përfundimtar në fund të vitit të tretë, pasi ka përmbyllur të gjitha detyrimet akademike dhe ekonomike. Provimi përfundimtar është shkrim. Në përputhje me afatet e përcaktuara në rregulloren e KUR, departamenti përgjegjës në bashkërendim me Zyrën e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve informon studentët për modalitetet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, programin që duhet të përgatiten. Rregullorja e diplomimit, përcakton në mënyrë të detajuar procesin e diplomimit. Provimi përfundimtar bëhet përpara një komisioni të propozuar nga drejtuesi i departamentit dhe miratimin e dekanit.</p> <p><i>Evidenca nr. 47: Programi mësimor Bsc në Fizioterapi.</i> <i>Evidenca nr. 7: Rregullore e programit mësimor, Kreu IV.</i> <i>Evidenca nr. 9: Rregullore e Diplomimit, nenet 64, 65 dhe 66.</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni se KUR organizon takime të hapura (periudha Mars - Maj) për informimin e maturantëve për programin e studimit <i>"Bachelor në Fizioterapi</i>, po ashtu ka publikuar një spote promovues për programin e studimit dhe fletëpalosje promovuese.</p> <p>Gjatë vizitave në institucion GVJ konstatoi se KUR ka strukturë (Drejtoria juridike, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI) që merret me gjurmimin e studentëve dhe organizimin e ditëve të hapura për informimin e studentëve të ardhshëm mbi programet e studimit. Takimet janë të organizuara (open day) dhe marrin pjesë pedagogët e njësisë bazë, anëtarë të personelit akademik, të cilët organizojnë takime periodike me nxënësit e shkollave të mesme. Përgjatë ditëve të regjistrimit, njësia kryesore vë në dispozicion të studentave të interesuar për të vazhduar studimet në programin e studimit Bachelor, grupe pedagogësh që japin informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe</p>



	<p>mundësitë e transferimit të studimeve në KUR dhe nga KUR tek universitetet me programe të ngjashme brënda dhe jashtë shtetit</p> <p><i>Info Day</i> organizohet sipas një kalendari të rakorduar me Drejtoritë Rajonale të Edukimit, takimet zhvillohen kryesisht në Vlorë, Fier, Berat, Lushnje, Sarandë.</p> <p><i>Evidenca nr. 111: Kalendari per informimin e nxënësve maturantë 2022.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 112: Fletëpalosja e KUR.</i></p> <p><i>Vizitë në institucion</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga KUR, konkludon se KUR vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentave referuese, planet mësimore, rregullore, sttutit, takimit me drejtues te institucionit, sekretarine mësimore, studentët konstaton se , KUR vendos në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit të programit mësimor dhe kohëzgjatjes së programit të studimit. Informacionin studentët e marrin nëpërmjet takimeve me stafin akademik që I pret në institucion , në momentin që interesohen për programet e studimit, nëpërmjet kontakteve me Zyrën e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve, si dhe vënies në dispozicion të studentëve të rregullores së brendshme dhe rregullores së programit të studimit, programit të studimit. Bazuar në programin e studimit dhe rregulloret e KUR që ndihmojnë dhe rregullojnë realizimin e programit mësimor , studentëve ju bëhet me dije që : Programi ka 180 kredite , të ndara në 60 kredite për cdo vit akademik dhe cdo vit akademik I ndarë në 2 semestre(sem I+II) me nga 15 javë mësimore cdo semester dhe 30 kredite cdo semestër. Në takimin me komisionin e kurrikulave ,bazuar në udhëzimin të mas si dhe Rregulloren e KUR në program vihet re se I kredit ekuivalentohet në orë mësimore sipas udhëzimeve të MAS.</p>
	<p>Ditën e parë bëhet takim informues e orientues për të gjithë studentët për aspektet e programit të studimit. Në vazhdim sigurohet asistencë e posçame nga personeli ndihmës mësimor për familjarizimin e studentëve me procesin mësimor. Forma e studimit është me kohë të plotë.</p>

	<p><i>Evidenca nr. 47: Programi mësimor BCs. Fizioterapi.</i> <i>Vizitë në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Bazuar në RVB,takimin me drejtues të institucionit, takimi me stafin akademik, sekretarinë mësimore si dhe takimi me studentët mendon se: KUR informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve edhe nëpërmjet web-it. Çdo fillim viti akademik në faqen web të KUR, dhe në hapësirën e fakultetit që ofron programin e studimit bëhet publike struktura e vitit akademik.</p> <p>Informacioni i nevojshëm publikohet në format letër, guida, rregullore dhe fletëpalosje, si dhe elektronikisht. Në formë të detajuar studentët kanë akses mbi ngarkesat, temat për çdo javë mësimore dhe literaturat e detyrueshme dhe ato të rekomanduara, detyrat apo diskutime të ndryshme, kreditet përkatëse, të cilat janë të shprehura qartë dhe në syllabuset e lëndëve të ndryshme. Studenti i akseson të gjitha të dhënat nëpërmjet llogarisë të dedikuar të sistemit të EMS dhe faqes zyrtare on - line të KUR . Studentët asistohen gjatë gjithë kohës nga stafi pedagogjik dhe sekretaria mësimore për cdo paqartësi . Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacione nga sekretaria mësimore nga faqja zyrtare, nga pedagogët për lëndët/ modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Informacionet gjenden edhe të afishuara në stendat e holleve të universitetit. Në fillim të çdo semestri, studentëve u vihet në dispozicion orari dhe ngarkesa mësimore semestrale. Po ashtu ora e parë studentët marrin info të detajuar nga pedagogët e lëndëve për syllabusin përkatës ku shprehen qartë: kreditet, kodi lëndor, raporti lexion/ seminar/ laborator/ praktik, temat, literaturë bazë dhe literaturën e rekomanduar, format e kontrollit dhe vlerësimit, detyrimet për lëndën (projekte, detyra kursi), niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 47: Programi mësimor.</i> <i>Evidenca nr. 49: Plani mësimor.</i> <i>Evidenca nr. 50: Syllabuset e programit mësimor.</i> <i>Evidenca nr. 7: Rregullore e programit.</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Pas kqyrjes së dokumentacionit të grupit të vetëvlerësimit, dhe gjatë takimeve të GVJ në institucion, u konstatuan përpjekje të vazhdueshme të KUR, për të studiuar tregun e punës dhe kërkesat e kriteret e tij. Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë orientimit të studentëve drejt tregut të punës, si në rang universiteti nëpërmjet Drejtorisë së Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni, ashtu si edhe Zyrës së Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI janë dy zyra të institucionit të cilat u japin studentëve informacione mbi mundësinë e punësimit. Nëpërmjet organizimit të praktikave mësimore në institucionet partnere, studentëve me performancën më të mirë u ofrohet mundësi</p>

	<p>punësimi reale ose projektet bashkëpunuese me KUR. Përmes aktiviteteve të vazhdueshme të sektorit të ALUMNIT, studentët kanë mundësi të marrin informacione dhe orjentim mbi tregun e punës duke hartuar periodikisht raporte me punësimin e studentëve të diplomuar në KUR. Deri tani rezultojnë që të gjithë studentët e diplomuar në programin e studimit janë të punësuar.</p> <p><i>Evidenca nr. 73: Të dhëna mbi punësimin e studentëve të diplomuar.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare web të KUR, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se studentëve, nëpërmjet web-it, sekretarisë mësimore dhe stafit akademik, në mënyrë të vazhdueshme u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor.</p> <p>Studentët marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në hapësirën respektive të programit të studimit në stendën informuese, e cila gjendet në një pozicion lehtësisht të aksesueshëm nga studentët, në hollin kryesor në hyrje të godinës. Informacioni i stendës përditësohet rregullisht me ndryshimet dhe njoftimet më të fundit. Faqja web dhe llogaritë në rrjetet sociale të universitetit dhe fakultetit janë një tjetër mjet për përditësimin e informacionit në kohë reale.</p> <p>Gjithashtu studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> <p><i>Evidenca nr. 47: Programi i studimit.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 56: Orari mësimor.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 69: Kalendari i provimeve.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 94: Të dhëna mbi laboratorët</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nga takimi me studentët GVJ konstanton se KUR vë në dispozicion të studentëve informacionin, dokumentacionin dhe udhëzues të posaçëm për lëndët dhe veprimtarinë formuese. Studenti i akseson të dhënat nëpërmjet llogarisë personale në sistemit SMI, sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë, që ata marrin në momentin e regjistrimit në KUR nga Zyra e IT, nga ku nga ku kanë të drejtë të futen në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit. Edhe në distancë, on-line përmes platformës studentët mund të shohin të dhënat në lidhje me programin e studimit, si edhe të komunikojnë me mesazhe në formë teksti me pedagogët e lëndëve dhe moduleve.</p> <p>Studentët nëpërmjet kodeve personale mund të përdorin këtë sistem kudo dhe në çdo moment, për të parë lëndët, pikët e provimeve, notat, transkriptin etj. Gjithashtu, në ëëbsite-in e IAL gjendet gjithë informacioni i nevojshëm për programin e studimit: Plani mësimor, Rregullorja e programit</p> <p>Informacioni është i aksesueshem në faqen elektronike të IAL: <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a></p>

	<a href="https://unireald.edu.al/course/programi-Fizioterapi/">https://unireald.edu.al/course/programi-Fizioterapi/</a> <a href="https://unireald.edu.al/it/fakulteti-i-shkencave-mjekesore/">https://unireald.edu.al/it/fakulteti-i-shkencave-mjekesore/</a> <i>Vizita në institucion</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ bazuar në RVB, guidën dhe takimet në institucion mendon se ky institucion vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për përmbajtjen e programit të studimit, objektivat, strukturën, organizimin, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Pas kqyrjes së dokumentacionit të grupit të vetëvlerësimit, dhe gjatë takimeve të GVJ në institucion, u konstatuan se Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI asiston në gjurmimin e studentëve dhe ka krijuar një databazë të të dhënave të gjurmimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhëna çdo vit. Institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me numrin e studentëve që vendosin të ndjekin programin Bachelor Fizioterapi, dhe sigurisht edhe për studentët që do të diplomohen përfshirë këtu edhe nivelin edhe cilësinë e tyre në përfundim të studimeve. Pranë sekretarisë ne u informuam për ecurinë vjetore të studentëve nga rregjistrimi e deri në përfundim të studimeve , të dokumentuara edhe fizikisht (rregjistra) dhe elektronikisht. GVJ konstatoi se Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca nr. 70: Të dhëna për numrin e studentëve të diplomuar në 5 vitet e fundit.</i></p> <p><i>Vizitë në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>KUR dhe respektivisht FSHM disponon statistika të sakta vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Fizioterapi si dhe për të gjitha programet e studimit që ofron KUR. KUR dhe respektivisht FSHM disponon statistika të sakta vjetore për numrin e transferimeve, largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimit me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Këto të dhëna ruhen edhe në sistem elektronik, SMI dhe menaxhohen nga sekretaria mësimore, nëpërmjet regjistrave të programit të studimit. Sekretaria mësimore na vendosi në dispozicion dosjen personale të çdo studenti, e cila krijohet që në momentin e regjistrimit të tij dhe përditësohet me të dhëna të tjera përgjatë "jetës universitare" të tij në KUR. Kjo dosje përditësohet edhe me elementë të tjerë si dokumentacioni i ndjekjes së praktikës profesionale, apo</p>

	<p>mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <p>GVJ gjatë inspektimit të dosjes dhe regjistrave të studentëve konstaon se ka një rritje të numrit të studentëve vit pas viti. Institucioni disponon statistika për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Të gjitha këto të dhëna administrohen në sekretarinë mësimore në IAL</p> <p><i>Evidenca nr. 71: Të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar, largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, deri në diplomimin e tyre në 5 vitet e fundit.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, RVB, referencave përkatëse konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe nga sekretaria . Çdo student ka dosjen e tij, ku përmbahen të gjitha të dhënat; nga momenti i regjistrimit e deri në diplomim. GVJ konstatoi se këto të dhëna janë të disponueshme në sekretarinë mësimore, në formë shkresore dhe në sistemin SMI të cilat janë të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave</p> <p><i>Evidenca nr. 71: Të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar, largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, deri në diplomimin e tyre në 5 vitet e fundit.</i></p> <p><i>Vizitëa në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës, RVB, takimin me drejtues, stafin akademik , sekretarine konstaton se, KUR bën kontrolle periodike, audit të brendshëm, harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Në fund të vitit kalendarik departamenti përgjegjës për programin e studimit analizon dhe harton një raport analitik mbi arritjen e objektivave formuese të programeve të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimit profesional, me qëllim për të identifikuar nevojat për përmirësime në të ardhmen. Një kopje e raportit të kësaj analize i përcillet dekanatit, që nga ana e vet i përpunon këto edhe mbi bazën e raporteve të ardhura nga departamentet e tjera, për të hartuar një raport analitik në nivel njësie kryesore. Ky raport shërben si bazë për hartimin e objektivave për vitin pasues.</p> <p><i>Evidenca nr. 13: Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.</i></p>
	<p><i>Evidenca nr. 38: Vendimin nr. 34, datë 09.05.2020, të Senatit Akademik</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike</p>	<p>GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit dhe drejtuesin e departamentit si dhe në të dhënat e RVB , konstaton se njësia bazë harton</p>

<p>mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>raporte periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, ecurinë në vitet akademike si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve për vitet e ardhshme akademik. Drejtuesit e njësive bazë këtë informacion vjetor, periodic të diskutuar më parë në departament e përcjell në dekanat , për hartimin e objektivave , kuotave për vitin pasues. Në analizën vjetore paraqeten rezultatet analitike mbi numrin e të regjistruarve, frekuentuesve dhe të diplomuarve të çdo programi studimi.</p> <p><i>Evidenca nr. 70: Të dhëna për numrin e studentëve të diplomuar në 5 vitet e fundit.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 72: Të dhëna për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve (nota mesatare).</i></p> <p><i>Evidenca nr. 73: Të dhëna për numrin e studentëve të punësuar në 5 vitet e fundit.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 76: Analiza vjetore e IAL.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ bazuar në RVB, guidën dhe takimet në institucion mendojnë se ky institucion realizon një audit të brendshëm periodik, mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi V.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ bazuar në: RVB, në takimin me studentët, në evidencat e vëna në dispozicion si: Statuti i KUR, Kreu 8 (Student dhe të dhëna mbi studentët), Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, Kreu 7, Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse (anëtar senati, i cili përfaqëson interesat e studentëve, anëtar në grupin e RVB, NJSBC, këshillin studentor etj),</p> <p><i>Evidenca nr. 2: Statuti, neni 10, pika 2, dhe neni 37</i></p> <p><i>Evidenca nr. 5: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 14: Rregullore e NJSBC</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin</p>	<p>Institucioni me anë të rregulloreve, statutit garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, vlerësimin mbi procesin akademik dhe realizimin e programit mësimor. Edhe në strukturën e NJSBC një prej anëtarëve është përfaqësues i Këshillit Studentor. Gjithashtu, edhe në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 54

<p>akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>grupin e brendshëm të vlerësimit të programit të studimit (GBV) njeri prej anëtarëve është student.</p> <p><i>Evidenca nr. 14: Rregullore e NJSBC, neni 4.</i>  <i>Evidenca nr. 40: Urdhër për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit.</i>  <i>Ref. Vizita në institucion.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributit të tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Institucioni bazuar në planin mësimor, rregulloren e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, Statutin KUR, modelin e syllabusi, regjistri i studentëve, institucioni ka parasysh ngarkesën e studentëve si dhe parashikon procedurë jo burokratike për përparimin, njohjen e studimeve të mëparshme. GVJ në takimin me studentët u informua se studentët janë pjesë aktive në institucion jo vetëm në realizimin e programit mësimor, por janë pjesë e vendim marrjes (senat, NJSBC, këshill studentor) FSHM ka ngritur mekanizma të komunikimit dhe tërheqjes së mendimit të studentëve nëpërmjet koordinatorit të programit, i cili organizon me ta takime të rregullta dhe sipas kërkesës së studentëve. Gjithashtu, pyetësorët që zhvillojnë 2 herë në vit, përmbajnë pyetje mbi vlerësimin që studentët kanë për përmbajtjen e programit të studimit. Programi i studimit është i riorganizuar dhe në këtë proces janë zhvilluar takime me studentët dhe sugjerimet e tyre janë marrë parasysh për programin final.</p> <p><i>Evidenca nr. 2: Statuti, neni 10, pika 2, dhe neni 37</i>  <i>Evidenca nr. 5: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.pdf</i>  <i>Evidenca nr. 14: Rregullore e NJSBC</i>  <i>nr. 113: Pyetësor për studentet</i></p> <p style="text-align: right;"><i>Evidenca Vizita</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentacionin si dhe takimet me studentët GVJ konstatoi se studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces transparent, i cili shprehet në rregulloret e brendshme dhe pasqyrohet në programin/ silabusin e secilës lëndë. Tezat e sekretuara, shpjegimet e pedagogut për vlerësimin, rishikimi i tezës dhe çelësit të përgjigjeve, dhe mundësia për rivlerësim nga një komision i posaçëm, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët kanë mundësi të parashtrijnë kërkesat e tyre duke ndjekur procedurat e parashikuara në rregulloren e institucionit. Gjatë takimit me drejtuesit e institucionit dhe studentët nuk kishte një rast të dokumentuar ankimi. Procesi i ankimit të rezultatit të provimit është i sanksionuar në rregulloren e departamentit dhe të programit të studimit dhe funksionon si më poshtë:</p> <p>Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Kërkesën për rivlerësimin studenti e dorëzon në sekretarinë mësimore brenda 48 orëve nga marrja e rezultatit, ankesa i paraqitet me shkrim drejtuesit të departamentit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë në dijeni dekanin. Dekani, brenda 48 orësh nga marrja dijeni për ankesën nga përgjegjësi i</p>

	<p>departamentit, ngre një komision <i>ad hoc</i> prej 3 anëtarësh, i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit duke rivlerësuar provimin me gojë ose me shkrim, ose studenti përsërit provimin në prani të komisionit <i>ad hoc</i>, duke tërhequr një tezë të dytë. Komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit.</p> <p>Ndryshimet në rezultatet e studentëve pasqyrohen në procesverbalin e ri të firmosur nga komisioni, i cili i bashkëlidhet procesverbalit të mëparshëm dhe në SMI.</p> <p><i>Evidenca nr. 4: Rregullore e përgjithshme, neni 58.</i>  <i>Evidenca nr. 7: Rregullorja e programit, neni 14.</i>  <i>Evidenca nr. 2: Statuti, neni 10, pika 2, dhe neni 37</i>  <i>Evidenca nr. 5: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.pdf</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ bazuar në RVB, guidën në institucion, takimin me stafin akademik dhe studentët mendon se ky institucion angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe ky anagazhim studentor rregullohet sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve , Statusit të KUR.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB, guidën në institucion, takimin me stafin akademik, dhe dokumenta të vëna në dispozicion si: Rregullore e NJSBC, Rrregullore e zyrës së karrierës dhe takimit me studentët konstaton se ky nsitucioni siguron informim, këshillim e orientim për studentët e të gjithë programeve dhe të gjithë cikleve të studimit, si në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore. Informimi I studentëve nga stafi, sekretaria bëhet që në ditët e informimit për të zgjedhur këtë universitet, po ashtu të drejtën e informimit studentët e marrin fizikisht në institucion te sekretaria, drejtuesit e institucionit, me anë të posterave të afishuara në vende të dukshme të institucionit, apo në distancë nëpërmjet informimit on line me anë të sitemit të MSI. GVJ mendon se këto të drejta të informimit studentor janë të shprehura dhe në rregullore të ndryshme dhe Statutin e KUR. Gjithashtu, zyra e zhvillimit të karrierës ofron asistencë për cdo student në disa drejtime si: Zgjedhja e programit të studimit , organizimi i praktikave, përfshirja në aktivitete akademike dhe profesionale,mundësitë e punësimit etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 14. Rregullore e NJSBC.pdf</i>  <i>Evidenca nr. 15: Rregullore e Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës.</i></p>



	<p><i>Evidenca nr. 17: Kodi i Etikës.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, takimet e realizuara me stafin, drejtuesit, sekretarinë, studentët GVJ konstatoi se KUR ka një system të mirë organizuar për informimin, këshillimin(MSI), ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor nga dita e regjistrimit deri në përfundim të studimeve. Studentëve u ofrohet shërbim i vazhdueshëm i këshillimit të karrierës me ndihmën e Drejtorisë së Koordinimit, Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, ALUMNI etj</p> <p>Koordinimi i aktivitetit të zyrave të mësipërme në rang institucioni është tregues të një sistemi të përshtatshëm të asistencës së vazhdueshme ndaj studentëve, e cila përditëson studentët me informacion të hollësishëm mbi mundësitë e pjesëmarrjes në trajnime profesionale, forume rinore, aplikimet e mundëshme në konferencat vendase, rajonale dhe ndërkombëtare, etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 14. Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 15: Rregullore e Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 17: Kodi i Etikës.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>GVJ sic e përmendëm dhe në kriterin 2, konstaton se KUR u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Studentëve u ofrohet këshillimi i karrierës, me anë të disa zyrave dhe drejtorive si, zyra e këshillimit të karrierës, drejtoria e koordinimit, marrëdhënieve me jashtë, ALUMNI. Këto zyra janë në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me, aktivitete të ndryshme studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, projekte të ndryshme, mundësi punësimi duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Gjithashtu KUR ka krijuar kontakte me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale/intershipeve të studentëve, por edhe të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata. Detyrat dhe funksionimi i Zyrës së Këshillimit të Karrierës në IAL janë të përcaktuara në Rregulloren e Këshillimit të Karrierës, miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik.</p> <p><i>Evidenca nr. 14. Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 15: Rregullore e Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, takimet e realizuara me stafin, drejtuesit, sekretarinë, studentët GVJ konstatoi se KUR ka një system të mirë organizuar për informimin, këshillimin e studentëve dhe ka disa zyra dhe drejtori të cilat ndjekin në mënyrë periodike studentët jo vetëm gjatë viteve akademike, por edhe pas punësimit të tyre. Drejtoritë dhe zyrat përkatëse si, Drejtoria e Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, ALUMNI mban kontakte për pjesëmarrje në</p>

organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	<p>trajtime pasuniversitare brenda apo jashtë vendit si dhe mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në KUR.</p> <p>Procesi i zhvillimit dhe këshillimit të karrierës është i lidhur ngushtësisht me mundësimin e punësimeve në institucionet jashtë vendit, falë bashkëpunimit të ngushtë me universitetin e Salernos, por njëkohësisht studenteve ju krijohet mundësia që nëpërmjet iniciativave publike e private, konferencave, leksioneve të hapura, projekteve studentore, aktivitete ekstra- kurrikulare, jo vetëm të përgatiten profesionalisht, por të kenë qasjen korrekte ndaj botës akademike, duke formuar një profili akademik individual .</p> <p>Student të diplomuar sivjet janë për herë të parë, pas mbylljes së marrveshjes me universitetin e Fogias, Itali.</p> <p><i>Evidenca nr. 14. Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 15: Rregullore e Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 70: Të dhëna për numrin e studentëve të diplomuar në 5 vitet e fundit.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ mendon si konkluzion se KUR ka procedura , zyra, drejtori, e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, e janë lehtësisht të arritshme nga studentët . KUR falë këtyre zyrave bën të mundur ndjekjen e punesimitin e tyre edhe pas mbarimit të studimeve.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b> <b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b> <b>X</b>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--




## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB, takimin me drejtuesit e institucionit, stafin, studentët , NJSBC, referencat e vëna në dispozicion , mendon se, KUR, ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe nëpërmjet NJSBC-së, siguron zbatimin një strategjie institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. NJSBC, e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, dhe në funksion plotësisht në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit. NJSBC vlerëson në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike funksionalitetin, efikasitetin dhe produktivitetin e stafit të IAL në lidhje me veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore. Mësimdhënia bëhet gjithmonë në përmirësim bazuar dhe në infrastrukturën, Sistemin MSI që aplikohet , në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi të statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore ,duke vënë në dispozicion metoda kreative jo vetëm në auditor por dhe në distancë për tematika të ndryshme mësimore, laboratore, detyra kursi etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 42: Manuali për studentët (Google Classroom).</i>  <i>Evidenca nr. 43: Manual për pedagogun (Google Classroom).</i>  <i>Evidenca nr. 44: Manual për programin OBS për regjistrim videodhe audio</i>  <i>Vizita në institucion.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Kolegji Universitar “Reald” ka një Njësi të Vlerësimit të Brendshëm të cilësisë e cila përbëhet nga 5 anëtarë(kryetari, expert të jashtëm, dy pedagog, një student). Kjo njësi kontrollon paraqet Rektorit një raport vjetor mbi aktivitetin mësimor, kërkimore dhe mbi shërbimet e ofruara nga IAL-ja. Njëkohësisht është përgjegjëse për mbledhjen, menaxhimin, ruajtjen dhe komunikimin e mendimeve të studnetëve për mësimdhënien që është dhënë. Për realizimin e funksioneve të saj Njësia bazohet në rregulloren e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit dhe ka të drejtën e aksesit në të gjitha dokumentet, dhe informacionet e tjera të KUR dhe në të njëjtën kohë të ruajë konfidencialitetin e dokumenteve të mbledhura. NJSBC në përfundim të vitit akademik harton raportin vjetor të cilin ia paraqet rektorit, së bashku me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti i NJSBC-së hartohet bazuar në anketimet e vazhdueshme të studentëve dhe në rezualtatet e monitorimit të kryera nga Njësia gjatë vitit akademik. Njësia vlerëson periodikisht efikasitetin dhe produktivitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore shkencore të KUR, duke përmbledhur të gjitha problematikat që mund të dalin nga ky vlerësim periodic. NJSBC shpesh herë konsultohet edhe me ekspertë të jashtëm, për një mbarëvajtje në të gjitha hallkat e procesit</p>

	<p>mësimor.</p> <p><i>Evidenca nr. 14: Regullore e NJSBC.</i>  <i>Evidenca nr. 89: Raport vjetor i NJSBC</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ në takimin e realizuar me studentët konfirmoi se KUR garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. Studentët referojnë se gjatë vititeve akademike, ata në formë elektronike plotësojnë një pyetësor anonym . Pyetësori ka disa rubrika të cilat lidhen kryesisht me, programin, lëndët syllabuset, mësimdhënia, performance e stafit akademik, ndihmës akademik, infrastrukturën etj. Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodic bëhet jo vetëm me anë të pyetësorëve tek studentët për mbledhjen e të dhënave lidhur me aspekte të ndryshme të veprimtarisë mësimore e asaj administrative, në përputhje kjo me pikat 3 &amp; 4 të nenit 103 të Ligjit 80/2015; por dhe takime formale dhe informale me studentët, kontaktimit akademik dhe administrativ nëpërmjet e-maili për marrjen e informacioneve të domosdoshme. Pas mbledhjes së informacioneve përkatëse bëhet raportime tek drejtuesit e KUR.</p> <p><i>Evidenca nr. 14: Regullore e NJSBC.</i>  <i>Evidenca nr. 89: Raport vjetor i NJSBC</i>  <i>Evidenca nr. 114: Model pyetësori për studentët i hartuar nga NJSBC</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se, të gjitha të dhenat e grumbulluara dhe të shfrytëzuara për ndryshimet në funksion të rritjes së cilësisë ruhen dhe i paraqiten Rektorit dhe Senatit Akademik nga Njësia e Vlerësimit të brendshëm në një raport vjetor mbi veprimtaritë e mësimdhënies, të kërkimit shkencor, mbi shërbimet e kryera nga KUR.</p> <p>Po ashtu, kjo njësi raporton në lidhje me rezultatet e shprehura nga studentët, si edhe mbi nivelin e funksionalitetit dhe efikasitetit të arritur nga njësitë specifike bëhet analiza e çdo problematike (departament, sekretari, biblioteke )etj. Në raportin vjetor, i paraqitet Rektorit dhe Senatit, me rekomandimet për vitin akademik pasardhës nëpërmjet rekomandimeve dhe analizave të synuara (të tipit SWOT). Raporti i NJSBC është publik dhe i aksesueshëm nga studentët dhe publiku në faqen web të IAL: <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a>.</p> <p><i>Evidenca nr. 14: Regullore e NJSBC.</i>  <i>Evidenca nr. 89: Raporti vjetor i NJSBC.</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit, përgjegjës in e departamentit, NJSBC , u informua se informacioni i mbledhur nga vlerësimi i bërë pasi i bëhet një përpunim statistikor i paraqitet Rektorit dhe Senatit, me rekomandimet për vitin akademik pasardhës nëpërmjet rekomandimeve dhe analizave të synuara (të tipit SWOT), duke nxjerr në pah mangësitë (nuk ka patur ndonje praktikë të tillë). Punonjësit promovohen me anë të suportit nga institucioni përsa i përket motivimit për kërkimin shkencor</p>

	<p>në mënyrë që të realizojnë detyrat në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe rregulloret e brendshme të KUR, FSHM si dhe rregulloren e programit të studimit duke garantuar rigorozitet në evidentimin e problemeve dhe efikasitet në zgjidhjen e tyre. Rezultatet e vlerësimit shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Ky plan hartohet në fillim të çdo viti akademik, i cili miratohet nga Rektori.</p> <p><i>Evidenca nr. 14: Rregullore e NJSBC.</i>  <i>Evidenca nr. 89: Raporti vjetor i NJSBC.</i>  <i>Evidenca nr. 115: Plan i Masave "Për minimizimin e rreziqeve për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia Covid-19".</i>  <i>Evidenca nr. 116: Plan Masash "Për zbatimin, kontrollin dhe raportimin e detyrave të parashikuara në planin vjetor të institucionit" (për semestrin e dytë, viti akademik 2019 – 2020).</i> <i>Evidenca nr. 117: Relacion "Për realizimin e detyrave të planifikuara në planin e masave "Për zbatimin, kontrollin dhe raportimin e detyrave të parashikuara në planin vjetor të institucionit".</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se KUR ka një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit të cilat ndihmojnë institucionin për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe performancën e stafit.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Gjatë guidës në institucion GVJ u informua se në mënyrë të vazhdueshme, realizohet një pyetësor anonim me studentët, me disa rubrika për mësimdhënien, programin, korrektësinë e stafit, ky vlerësim menaxhohet nga, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, me Vendim të Senatit Akademik të KUR përbëhet nga 5 anëtar (1 kryetari, 2 pedagogë, 1 student, 1 expert i jashtëm), përbërja e NJSBC përcaktohet edhe në Statutin e KUR në „KUR synimi kryesor i strukturës dhe procedurave për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është arritja e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit, duke përdorur mekanizma të sigurimit të cilësisë në çdo aspekt. NJSBC ka politika dhe funksionon në bazë të legjislacionit në fuqi, pikat 3 &amp; 4 të nenit 103 të Ligjit 80/2015 të IALP si dhe rregulloreve të brendshme të KUR dhe Statutit të KUR.</p>

	<p>GVJ mendon se në institucion SBC është njësi specifike përgjegjëse për monitorimin, shqyrtimin, mbikqyerjen, rishikimin e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca nr. 2: Statuti i KUR, nenet 27 dhe 28</i>  <i>Evidenca nr.4: Rregullore e pergjithshme, neni 13, pika 1,germa“i”</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, vizitën në institucion mendon se KUR, përmbush kriteret ligjore dhe ka ngritur NJSBC. KUR ka një NJSBC, e cila përbëhet nga 5 anëtarë, sipas Statutit të KUR ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm (1 Kryetari, 2 pedagog, , 1 expert I jashtëm dhe 1 përfaqësues i studentëve).</p> <p>Kjo njësi kontrollon, paraqet Rektorit një raport vjetor mbi aktivitetin mësimor, kërkimore dhe mbi shërbimet e ofruara nga IAL-ja. Njëkohesisht është përgjegjëse për mbledhjen, menaxhimin, ruajtjen dhe komunikimin e mendimeve të studnetëve për mësimdhënien që është dhënë.</p> <p>Për realizimin e funksioneve të saj Njësia bazohet në rregulloren e funksioneve të Njesisë së Vlerësimit dhe ka të drejtën e aksesit në të gjitha dokumentet, dhe informacionet e tjera të Kolgjit Universitar dhe në të njëjtën kohë të ruajë konfidencialitetin e dokumenteve të mbledhura. Gjithashtu NJSBC në fillim të vitit akademik harton planin vjetor të punës.</p> <p><i>Evidenca nr. 3: Strategjia e Zhvillimit Institucional.</i>  <i>Evidenca nr. 86: Plan pune i NJSBC.</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB, guidën në institucion dokumentat e vëna në dispozicion se , ky institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. NJSBC ka rolin kryesor në monitorimin e cilësisë. Ky monitorim realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p> <p>Ne konstatojmë se institucioni përdor në nivel operacional:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li><i>pyetësorët tek studentët</i> për mbledhjen e të dhënave lidhur me aspekte të ndryshme të veprimtarisë mësimore e asaj administrative, në përputhje kjo me pikat 3 &amp; 4 të nenit 103 të Ligjit 80/2015;</li> <li>Takime formale dhe informale me studentët</li> <li>kontaktim akademik dhe administrativ nëpërmjet e-maili për marrjen e informacioneve të domosdoshme</li> </ol> <p>Në aspektin taktik, institucioni përdor:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li><i>raportime tek drejtuesit;</i></li> </ol> <p>Sa i përket aspektit strategjik, NJSBC ka gjeneruar informacion sasior dhe cilësor, për të ardhur në ndihmë edhe GVJ në ndihmë të akreditimit të jashtëm, në përputhje me parashikimet e Ligjit 80/2015 në këtë aspekt. Të dhënat e këtij monitorimi diskutohen në njësitë bazë , dekanati , rektorat, senat dhe shohin mundësitë për përmirësimin e problematikave. Të gjitha të dhënat e grumbulluara nga të anketuarit</p>



	<p>përpunohen nga NJSBC dhe i paraqiten autoriteteve drejtuesnë IAL për njohje dhe vlerësim.</p> <p><i>Evidenca nr. 3: Strategjia e Zhvillimit Institucional.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 86: Plan pune i NJSBC.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 114: Model pyetësori për studentët i hartuar nga NJSBC.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ mendon se KUR përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, për pasqyrimin performancës së stafit . Sic jemi shprehur dhe më lart në KUR përgatitet në mënyrë periodik analizat vjetore në bazë institucionale, në çdo njësi bazë. Aty përshkruhet pjesa më e madhe e informacionit mbi ngarkesën mësimore, aktivitetin shkencor, cilësinë e lexioneve të miratuara më parë në departament, të dhënat e dala nga monitorimi i vazhdueshëm i stafit. Ky raport më pas u dërgohet dhe vihet në dispozicion edhe stafit akademik dhe administratës. Këtë detyrë e ushtron Zyra e NJSBC nëpërmjet pyetësorëve dhe përpunimit të të dhënave dhe e paraqet atë në raportin e saj vjetor.</p> <p><i>Evidenca nr. 86: Plan pune i NJSBC.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 89: Raporti vjetor i NJSBC.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 114: Model pyetësori për studentët i hartuar nga NJSBC.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ pas shqyrtimit të RVB, dokumentave të vëna në dispozicion, guidës në KUR mendon se KUR, zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe rregulloret e brendshme të KUR.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi VI.3</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p>	<p>GVJ nga takimi me përfaqësues të institucionit konkludon se në mënyrë periodike institucioni është kujdesur për vlerësimin e brendshëm si në nivel fakulteti ashtu dhe departamenti duke hartuar raport përkatëse të veprimtarisë. Ky raport shërben si dokument bazë për vetëvlerësimin e programeve të studimit. Gjithashtu raportet e vlerësimit të brendshëm ishin pjesë e dokumentacionit të shfrytëzuar gjatë procesit të akreditimit institucional. Në këtë raporte evidentohen arritjet dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. Miratimi i programi i studimit kalon nëpërmjet njësive bazë, miratimin në dekanat, e mandej në Senatën Akademik. Ky i fundit i a</p>

<p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>kalon për miratim Bordit të Administrimit, i cili pasi e shqyrton dhe miraton ia rikthen IAL për ta përcjellë për miratim final nga MASR. Njësia bazë është përgjegjëse për hartimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, që fillon me planin e studimit, programin e studimit, syllabuset e lëndëve/ moduleve, sublementin e diplomës etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 75: Procedura e miratimit të programit të studimit.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Sipas takimit me përfaqësues të insitucionit dhe dokumentat e vëna në dispozicion GVJ mendon se NJSBC përgatit dhe shpërndan në formën e një analize vlerësimit periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e programeve të studimit (përmes anketimeve me pyetësorë dhe fokus grupe), i cili u vihet në dispozicion Rektorit. Strukturat drejtuese i përfshijnë elementë të këtyre raporteve si pjesë e diskutimit në nivel departamenti, në nivel fakulteti dhe në nivel rektorati dhe në senat. Raportet e vlerësimit të NJSBC përfshijnë rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p> <p>Raportet e vlerësimit të NJSBC , për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, realizon pyetësorë anonim , ku studentët japin mendimin e tyre në lidhje me zhvillimin e komponentëve të modulit, përgatitjen e pedagogut, sjelljen etj, etj. Studentët shprehin mendimin e tyre në sondazhe, intervista të dryshme të realizuara nga Zyra e Karrierës dhe Alumni, apo nga punë dhënës të ndryshëm. Instrumentet kryesor që përdoren për përfshirjen e studentëve janë edhe zhvillimi i pyetësorëve online, fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamenteve, etj. KUR ka krijuar praktikë pune që duke vlerësuar situatën e krijuar për cdo situatë të krijuar harton planin e masave konkrete në funksion të përmirësimit të cilësisë së procesit mësimor. Psh. Plan i masave më minimizimin e rreziqeve për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia Covid-19, Plani i masave që lidhet me realizimin e detyrave të planifikuara. Ky plan hartohet në fillim të çdo viti akademik. IAL ka hartuar një plan masash me detyra konkrete, i cili është miratuar nga Rektori.</p> <p><i>Evidenca nr. 115: Plani Masash "Për minimizimin e rreziqeve për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia Covid-19".</i></p> <p><i>Evidenca nr. 116: Plan Masash "Për zbatimin, kontrollin dhe raportimin e detyrave të parashikuara në planin vjetor të institucionit" (për semestrin e dytë, viti akademik 2019 – 2020).</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si</p>	<p>GVJ në bazë të RVB, vizitës në institucion mendon se KUR në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si:</p> <p>Teste të standardizuara;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dëgjime në auditor;</li> </ul>



<p>vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi me pikë;</li> <li>- Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module;</li> <li>- praktikë;</li> <li>- Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët;</li> <li>- Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës/laboratoreve.</li> <li>- Kontrolli periodik i të gjitha proceseve akademike përfshirë mësimdhënien dhe mësimnxënies</li> <li>- Ecuria e kontrollit të zbatimit të kurrikulës,</li> <li>- Kontroll periodik për realizimin e programeve, syllabuseve sipas modelit të miratuar</li> </ul> <p>Për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor, zhvillohen dhe vizitat nga eprori (Përgjegjës departamenti /Dekani) gjatë zhvillimit të një ore mësimi. Ky proces përfundon me plotësimin e një raporti vlerësimi. Në kushtet e përdorimit të platformave on line si Sistemi i MSI ,KUR dokumenton, monitorimin e zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, praktikave etj e cila është mundësuar nga Zyra e IT në KUR nëpërmjet raporteve të vazhdueshme mbi prezencën në mësim, mbi kohëzgjatjen e orëve mësimore, etj. GVJ konstaton se këto metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës etj janë pothuajse dy herë në vit me pyetësor anonym dhe herë pas here nga drejtuesit e departamentit në auditore, laboratore. Për cdo konstatim ka një raport mbi këto vlerësime.Nga mbledhja e të dhënave nuk ka ndonjë rast konkret për tu tërhequr vëmendje .</p> <p><i>Evidenca nr. 86: Plan pune i NJSBC.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 89: Raporti vjetor i NJSBC.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 114: Model pyetësori për studentët i hartuar nga NJSBC.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentat e vëna në dispozicion dhe takimi me përfaqësues të KUR konstaton se, institucioni ka zhvilluar pyetësor anketues me studentë me qëllim përmirësimin e procesit të vlerësimit të studentëve në programe specifike.</p> <p>Metodat e tërthorta përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve.</li> <li>• Sondazhe: të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit.</li> <li>• Pyetje konceptuale.</li> <li>• Intervista. Vlerësimi me pikë me anë testimeve</li> <li>• Teste të ndërmjetëm dhe përfundimtar; provime për module, praktikë</li> <li>• Vlerësimi i të detyrave të kursit, punëve individuale dhe punëve në grup/detyrave/projekteve që kryhen nga studentët;</li> </ul> <p>Për stafin akademik, në mënyrë periodike dhe sistematike janë zhvilluar kontrole të ndryshme nga eprori përgjegjës në njësisë bazë, dekani, zv. dekani, gjatë kryerjes së orëve mësimore në auditor, orëve praktike në laborator dhe orëve të lëndës praktikë që zhvillohen jashtë institucionit me institucionet me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesëve të institucionit, atyre</p>

	<p>të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, si dhe ato me pedagogët gjatë shqyrtimit të performancës së tyre. KUR në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit për këtë qëllim IAL ngre grup pune, i cili asiston studentët në orientimin e procesit të sondazheve, si dhe u krijon mundësi që në anonimitet të plotë të plotësojnë pyetësorët përkatës, duke i'u vënë në dispozicion salla dhe kompjutera.</p> <p><i>Evidenca nr. 41: Urdhër për ngritjen e grupit të punës për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 49. Plani-mësimor Bsc në "Fizioterapi", i riorganizuar (2021-2024).pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 89. Raport vjetor i NJSBC për vitin akademik 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 113. Pyetësor për kushtet në IAL - plotësohet nga studentet.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 114. Model pyetësori për pedagogun e lëndës, i hartuar nga NJSBC - plotësohet nga studentet..pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 93. Analiza vjetore e IAL për vitin akademik 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ mendon se ky institucion e plotëson këtë standart pasi vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet dhe disponon raporte periodike të vlerësimit.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB, në ligjin 80/2015 neni 103, VKM 531 dt 11.9.2018 (Kodi i Cilësisë) Statutin institucional si dhe duke referuar rregullores së NJSBC. Detyrat dhe funksionimi i NJSBC në IAL janë të përcaktuara në Rregulloren e NJSBC, miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017, të Senatit Akademik.</p> <p>Në përbërje të NJSBC është përfshirë një ekspert i jashtëm dhe 4 të brendshëm: 1 student dhe 3 staf akademik. NJSBC funksionon me anë të manualit të Cilësisë ku përcaktohet roli i strukturave akademike dhe administrative si dhe roli i Senatit Akademik lidhur me sigurimin e Cilësisë. Një nga këto politika, është ngritja pranë departamenteve e organeve këshilluese të Bordeve të Tregut të Punës</p> <p>Po ashtu, përfshirja dhe angazhimi në NJSBC i një eksperti të jashtëm, i cili i përgjigjet nevojës së institucionit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm.</p>

	<p>Lidhur me sigurimin e cilësisë, ka patur gjithashtu shkëmbime të stafit akademik dhe administrativ – me focus në mësimdhënie dhe trajnim – në kuadër të projektit Erasmus+. Detyrat dhe funksionimi i NJSBC në IAL janë të përcaktuara në Rregulloren e NJSBC, miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017, të Senatit Akademik.</p> <p><i>Evidenca nr. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD.pdf</i>  <i>Evidenca nr. 4. Rregullore e Pergjithshme e IAL..pdf</i>  <i>Evidenca nr. 14: Rregullore e NJSBC</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në takimin e realizuar me stafin dhe Studentët ,GVJ u informua se studentët përfshihen në vlerësim përmes anketimit, dhe forumeve të debatit. Përfshihen edhe në vendimmarrje përmes përfaqësisë së tyre në Senatin Akademik, si pjesë e Qeverisjes së KUR , përfaqësisë në Komisionin e Etikës, Këshillit studentor, si dhe përfaqësisë në NJSBC. Gjithashtu, përgjegjësitë, detyrat e NJSBC janë të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit si : rrit profilin e Sigurimit të Cilësisë duke kultivuar një kulturë cilësie në KUR, siguron vijueshmërinë periodike dhe të përvitshme të programit të Sigurimit të Cilësisë; lehtëson grumbullimin e informacionit mbi raportet e Sigurimit të Cilësisë; lehtëson dhe inkurajon stafin në procesin e mësimdhënies dhe vlerësimit; administron të dhënat statistikore me qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë; merr përgjegjësinë për çdo lloj procesi shtesë të Sigurimit të Cilësisë, si rishqyrtimet periodike, etj; merr drejtimin në përgatitjen e dokumenteve për qëllime të jashtme si: akreditimi, bashkëpunimi i KUR me organizata dhe institucioneve relevante, pajis Rektorin me raport mbi sigurimin e cilësisë; siston dekanët dhe fakultetet në zhvillimin dhe vënien në jetë të procedurave për verifikim dhe përmirësim të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca nr. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD.pdf</i>  <i>Evidenca nr. 4. Rregullore e Pergjithshme e IAL..pdf</i>  <i>Evidenca nr. 14: Rregullore e NJSBC (nenet 5 dhe 6).</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bisedave të zhvilluara, mund të pohojmë një gjithëpërfshirje në procesin e veprimtarisë së NJSBC të pedagogëve, stafit Administrativ, të cilët organizohen në mbledhje të vazhdueshme të Departamentit si hallka e parë e shprehjes së nevojave për përmirësime apo ndryshime në programet e studimit. Në përbërjen e NJSBC-së si organ kolegjal, miratohet me vendim të SA dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 3 (tre) janë përfaqësues të personelit akademik, 1 (një) përfaqësues i Këshillit Studentor dhe 1 (një) ekspert i jashtëm.</p> <p><i>Evidenca nr. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD.pdf</i>  <i>Evidenca nr. 4. Rregullore e Pergjithshme e IAL..pdf</i>  <i>Evidenca nr. 14: Rregullore e NJSBC, neni 4).</i></p>
	<p><i>Evidenca nr. 34: Vendim i SA për miratimin strukturës së Sigurimit të Cilësisë dhe të Këshillimit të Karrierës.</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm</p>	<p>KUR është i angazhuar në respektimin e integritetit akademik dhe në shmangien e çdo diskriminimi apo pabarazie të të gjithë palëve të</p>

<p>në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>përfshira në këtë proces vlerësimi. Përzgjedhje e aktorëve të brendshëm në proceset periodike të vlerësimit bëhet nga nga personeli akademik ku merren parasysh disa kritere të përfshirjes si, integriteti, aftësitë dhe kompetencat profesionale; mundësitë për përtimin dhe grumbullimin e informacionit dhe përpunimin e tij me qëllim realizimin e vlerësimeve të ndryshme. Procesi i vlerësimit zhvillohet duke respektuar Kodin e Etikës dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik dhe studentëve. Për të siguruar përfshirjen e plotë të stafit në përmirësimin e cilësisë së programit, KUR ka krijuar grupet e punës që sigurojnë këtë të fundit në për mbarevajtjen në drejtim të kurrikulës, veprimtarisë shkencore dhe vëmendjes ndaj studentëve. Nga takimet me përfaqësues të NJSBC nuk u konstatuan ankesa apo raportime në këtë drejtim. Njëkohësisht nga baza dokumentare dhe RVB nuk konstatohen elemente që të krijojnë dyshime për trajtim diskriminues në përfshirjen e dhe aktivizimin sa i përket proceseve vlerësuese. Pyetësorët deklarohen nga koordinatori se janë anonim dhe në raportin e NJSBC del se në Zyrën e Statistikës nuk përmbahen emra me kontekst denigrues, fyes apo diskriminues, në respektim të Kodit të Etikës. Gjatë implementimit të instrumentave të drejtpërdrejta dhe tërthorta të përdorur prej strukturave përkatëse me qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit është respektuar liria dhe etika akademike, Ligji nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe Rregullorja për ruajtjen, përpunimin dhe sigurinë e të dhënave personale. Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit realizohet edhe nga studentët e çdo kursi në mënyrë anonime duke ruajtur konfidencialitetin e tyre. Nuk ka ndodhur në asnjë rast që studentët / pedagogët të ankohen për shfaqje të dukurisë së diskriminimit apo pabarazisë.</p> <p><i>Evidenca nr. 89: Raport vjetori i NJSBC</i>  <i>Evidenca nr. 13: Rregullorja për ruajtjen, përpunimin dhe sigurinë e të dhënave personale.</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Përveç vlerësimit të brendshëm, element tjetër i sigurimit të cilësisë është dhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet hartimit të raporteve të vlerësimit, ku pasqyrohet gjendja aktuale dhe jepen rekomandime me qëllim përmirësim të përmbushjes së standardeve të cilësisë.</p> <p>Po ashtu KUR është i hapur dhe shumë aktive për realizimin sa më cilësor të proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe gjithashtu edhe për angazhimin e ekspertëve të jashtëm të cilët mund të japin ekspertizën dhe mendimet e tyre në bashkëpunim me strukturën e NJSBC-së, por edhe me takime me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtare janë element që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca nr. 2: Statuti i IAL, neni 27, paragrafi 2).</i>  <i>Evidenca nr. 34: Vendim i SA për miratimin strukturës së Sigurimit të Cilësisë dhe të Këshillimit të Karrierës.</i></p>

	<i>Vizitë në institucion</i>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ pas shqyrtimit të RVB, dokumentave të ndryshme të vëna në dispozicion si guidës në institucion mendon se KUR përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon institucionin në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. <b>GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ bazuar në evidencat e vëna në dispozicion konstaton se Institucioni e ka në vëmendje të politikave të ndryshme dhe veprimtarinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. GVJ konstatoi se NJSBC, është e përpiluar në përputhje me Rregulloren mbi funksionet e njësisë së vlerësimit të cilësisë si dhe ligjin mbi privatësinë dhe etikën akademike. NJSBC harton raportin e punës së vet, dhe jep rekomandime të shoqëruara me një analizë përmbledhëse. Këto rekomandime janë shumë të rëndësishme për autoritetet vendimmarrëse të KUR, pedagogët si dhe studentët, në mënyrë që problematikat të konstatohen në kohë reale dhe po kështu zgjidhja e tyre të bëhet në kohë reale. NJSBC e paraqet raportin vjetor në Rektorat dhe në Senatit dy organe të rëndësishme vendimmarrëse të KUR. Këto të dhëna janë transparente dhe publike për të gjithë palët e interesuara në faqen web të IAL: <a href="http://www.unireald.edu.al">www.unireald.edu.al</a> . <i>Evidenca nr. 89: Raporti i NJSBC.</i> <i>Vizita në institucion</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga kontakti me përfaqësues të institucionit dhe shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar prej KUR konstatohet se institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike dhe po ashtu të dhënat personale. Kanë të miratuar rregullore për ruajtjen e të dhënave ku përcaktohet detyrimi për mbrojtjen e të dhënave. Në faqen eeb publikohen të gjitha politikat dhe praktiket e sigurimit të cilësisë të cilat janë të aksesueshme për të gjithë. Në takim me drejtues të institucionit sic jemi shprehur dhe në standartet e mësipërme, GVJ u informuam se, NJSBC kryhen në mënyrë periodike shpërndarjen e pyetësorëve për të cilët është punuar edhe menduar që të jenë të personalizuar dhe të detajuar për secilin lëndë/modul/ dhe me emër mbiemër të lektorit/ pedagog përkatës. Ato shpërndahen në mënyrë elektronike anonime me link dhe ose me fletë për secilin semester përpara fillimit të sezonit të provimeve. Informacioni i mbledhur i vihet në dispozicion drejtuesve të njësisë bazë. Institucioni me qëllim respektimin e lirisë dhe etikës akademike, bazuar në legjislacionin në fuqi, kujdeset për ruajtjen e të dhënave personale dhe

	<p>garanton të drejtat njëkohësisht edhe detyrimet e palëve. Në çdo rast publikimet mbi rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit monitorohen nga përfaqësuesi i Komisionerit për të dhënat personale. Informacioni i publikuar në raport respekton lirinë dhe etikën akademike si dhe Ligjin nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.</p> <p><i>Evidenca nr. 12: Rregullore për “Mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e dhënave personale”.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 89: Raporti i NJSBC. Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Nisur nga analiza e raporteve të vlerësimit, Stafet angazhohen në plotësimin e rekomandimeve, ndjekjen e udhëzimeve për veprimet e marra. Masat, që synojnë përmirësimin e elementëve të evidentuara për rishikim, dokumentohen në formën e planeve të masave me qëllim përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Në zbatim të rekomandimeve angazhohet stafi akademik dhe ai ndihmës akademik. Disa nga aktivitetet të realizuara nga KUR për përmirësimin të cilësisë mendojmë që janë: Pjesëmarrje dhe bashkëorganizim i aktiviteteve/konferencave shkencore me partnerë ndërkombëtarë , Zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme të fokusuara kryesisht në aspektet didaktike të mësimdhënies dhe kërkimin shkencor, Mbështetja e stafit akademik, studentëve në aktivitete të ndryshme kërkimore shkencore, projekte brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Leksionet e hapura dhe çorkshop me studentët nga ekspertë të fushës së rehabilitimit</p> <p>Rezultatet e vlerësimit shoqërohen me një plan masash, ky plan me detyra konkrete hartohet në fillim të çdo viti akademik dhe miratohet nga Rektori.</p> <p><i>Evidenca nr. 116: Plan Masash “Për zbatimin, kontrollin dhe raportimin e detyrave të parashikuara në planin vjetor të institucionit”.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 89: Raporti i NJSBC. Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi sic e kemi përmendur dhe në standartet e mësipërme ka në transparencë në publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. GVJ konkludon në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni se KUR vlerëson dhe përpqet për efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive për monitorimin e cilësisë me qëllim përmirësimin e programit të studimit. Konkretisht cdo vit realizohet analiza e punës mësimore e cila shoqërohet nëpërmjet “kontrollit të kryqëzuar” (cross-check) që implementohet nga struktura dhe aktorë të brendshëm në KUR, duke filluar nga njësitë bazë nëpërmjet drejtuesit të departamentit, përgjegjësit të grup-lëndëve , koordinatorit të programit, te strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë e Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. IAL-ja bënë analizën e realizimit të detyrave, si dhe nxjerr rekomandime për ecurinë e mëtejshme të aktivitetit në IAL.</p>

	<p><i>Evidenca nr. 116: Plan Masash "Për zbatimin, kontrollin dhe raportimin e detyrave të parashikuara në planin vjetor të institucionit".</i></p> <p><i>Evidenca nr. 89: Raporti i NJSBC.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 117: Relacion per realizimin e detyrave te planifikuara në planin e masave "Për zbatimin, kontrollin dhe raportimin e detyrave të parashikuara në planin vjetor të institucionit".</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me drejtues të KUR dhe stafin akademik, dokumentave të vëna në dispozicion, konstatoi se institucioni organizon një plan të punës në përputhje me rregulloren e programit të studimit Bachelor në Fizioterapi, rregullore së përgjithëshme të institucionit , dhe planit të veprimit të NJSBC për arritjen e synimeve. Gjithashtu KUR organizon mbledhjet e Departamentit si dhe mbledhjet e Asamblesë Akademike, të cilat përbëjnë dhe mënyrat më të shpeshta të informimit mbi arritjet dhe problematikave; në këto mbledhje bëhet identifikimi i nevojave për ndërhyrje apo për përmirësim të programit të studimit. Me qëllim ngritjen e kulturës së cilësisë Institucioni organizon aktivitete si: seminareve informuese me studentët, kryesisht në trajtën e fushataveinformuese me anë të plotësimit të pyetësorëve, pjesëmarrja në Sondazhin Kombëtar të Studentëve, leksione të hapura,Takimeve të drejtpërdrejta me studentët , publikimit të njoftimeve në rrjetet online të KUR, publikimit të njoftimeve në llogaritë personale në SMI, etj.Gjithashtu, Institucioni ofron trajnime profesionale, në mënyrë periodike në FSHM organizohen në bazë departamenti apo fakulteti aktivitete të ndryshme: seminare, ëorkshop-e, trajnime, leksione të hapura, simpoziume, konferenca kombëtare ose ndërkombëtare. Përgjithësisht vendi i zhvillimit ka qenë në ambientet e FSHM dheSpitalit Rajonal të Vlorës. Pjesëmarrja është kryesisht nga ish-studentë të programeve të shkencave mjekesore . Në Janar 2020 Departamenti organizoi Konferencën shkencore "Promocion në Shëndetit" me temë "Kanceret e aparatit riprodhues femëror – një shqetësim madhor për këtë grup popullate", në të cilën përveç sfatit akademik dhe atij mjekësor në qytetin e Vlorës, morën pjesë edhe studentët e FSHM dhe studentë të diplomuar më parë. Referimet e kësaj konference u përzgjedhën tërësisht nga studimet shkencore të alumnëve të botuan në Buletinin Shkencor Reald. Çdo aktivitet paraqitet me një përshkrim të shkurtër dhe foto ilustruese në ëebsite-in e KUR: <a href="https://unireald.edu.al/aktivitete-shkencore/">https://unireald.edu.al/aktivitete-shkencore/</a></p> <p><i>Evidenca nr. 108: Leksion i hapur "Mbrotjtja e jetës dhe shëndetit nga veprat penale".</i></p> <p><i>Evidenca nr. 109: Leksion i hapur "Profesionet e rregulluara dhe procedura ligjore për marrjen e liçences së ushtrimit të profesionit".</i></p> <p><i>Evidenca nr. 107: Konferenca shkencore me temë "Kanceret e aparatit riprodhues femëror". 2020</i></p> <p><i>Evidenca nr. 88: Plan pune i kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 90: Raport vjetor i kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 106: Lista e aktiviteteve shkencore të zhvilluara në IAL</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>

<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ gjatë takimit me drejtues të KUR konstatoi se KUR organizon Politika të ndryshme të vlerësimit, dhe veprimtari për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, të cilat janë publike dhe transparente për të gjitha grupet e interesit.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Fizioterapi” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “REALD”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Nevoja në rritje e tregut të punës për këta profesionista.
2. Program mësimor i konsoliduar dhe i strukturuar sipas tregut të punës.
3. Infrastruktura e laboratorëve të rehabilitimit me paisje rehabilituse të kohëve të fundit në ndihmë të cilësisë së mësimdhënies për student të Bachelor.

**Pikat e dobta:**

1. Numri i pakët i stafit akademik të brendshëm me tituj, grada dhe trajnime profesionale, kryesisht për lëndët profesionale në Programin Bachelor në Fizioterapi.  
**(Standarti IV.1 .Kriteri 1).**
2. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në vite nuk është korrekt me Udhëzimin Nr. 29, datë 10/09/2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL.  
**(Standarti IV.1 .Kriteri 2).**
3. Sasia e pamjaftueshme e literaturës për lëndët profesionale të Programin Bachelor në Fizioterapi (shqip dhe në gjuhë të huaj) në bibliotekën e institucionit.  
**(Standardi II.4, kriteri 5); (Standarti IV.3 .Kriteri 1).**

**Rekomandime**

1. Rekrutim të stafit akademik me grada shkencore apo tituj akademik në fushën e programit të studimit Bachelor në Fizioterapi.
2. Paisja e bibliotekës me literaturë të lëndëve profesionale për Programin Bachelor në Fizioterapi.
3. Shpërndarja e ngarkesës mësimore sipas legjislacionit në fuqi Udhëzimin Nr. 29, datë 10/09/2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL
4. Të punohet më shumë me marketingun e kësaj diplome për plotësim të kuotave të propozuara.



**Summary Conclusions of the External Evaluation Report, of the first cycle study program Bachelor in “Physiotherapy”, of the Higher Education Institution University College “REALD”**

**Strengths /Affirmations:**

- 1- The growing demand of the labor market for these professionals.
- 2- The study program is consolidated and structured in accordance with the labor market.
- 3- The infrastructure of rehabilitation laboratories is completed with modern equipment, to help the quality of teaching for the students of Bachelor in “Physiotherapy”.

**Weaknesses:**

- 1- The small number of internal academic staff with required titles, degrees and professional training, mainly for professional subjects in study program Bachelor in Physiotherapy **(Standard IV.1, Criterion 1)**.
- 2- The distribution of the teaching load is not in accordance with Instruction No. 29, dated 10/09/2018 "On the activity and teaching load of academic staff in HEI". **(Standard IV.1, Criterion 2)**.
- 3- The insufficient amount of literature in library for the professional subjects of the study program in Physiotherapy in Albanian and in foreign languages. **(Standard II.4, Criterion 5), (Standard IV.3, Criterion 1)**.

**Recommendations:**

- 1- Recruitment of academic staff with appropriate academic titles in the field of the study program in Physiotherapy.
- 2- The library should be complete with more literature of professional subjects for the study program.
- 3- The distribution of the teaching load should be according to the legislation, Instruction No. 29, dated 10/09/2018 “On the activity and teaching load of academic staff in HEI”.
- 4- The institution should work more with the marketing department for the study program in Physiotherapy to meet the proposed quotas.



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

